



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e tretë (III) të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, më datë 30.4.2015 me këtë:

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 1. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2015
 2. Raporti financiar Janar-Mars 2015
 3. Propozim vendimi për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronë e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike “Deponia e mbeturinave”-Velekincë
 4. Propozim vendimi për lejin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës për nevojat e Xhamisë në Lagjen “Zabeli i Sahit Agës”
 5. Projekt Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transparencën në Komunën e Gjiçanit, 01.Nr.2681 i datës 12.03.2008
 6. Projekt Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukurit që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre
 7. Propozim vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor
 8. Propozim Plani i punës i KKSB për vitin 2015

3 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min

Në punimet e Seancës së tretë (III) morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Drejtorët e drejtorive

Zyrtari i Zyrës Ligjore, z. Hevzi Matoshi

Përfaqësuesi i OSB-së Basri Sejdiu

Përfaqësuesi i KDI-së (Instituti Demokratik i Kosovës), z. Driton Selmanaj

Përfaqësuesi i OJQ “Anamorava”, z. Isa Shefkiu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Seancën e tretë të KK-së e hapi dhe udhëhoqi, zonja Valentinë Bunjaku- Rexhepi e cila i përshëndeti të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit në sallë dhe kërkoi nga sekretari që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Në punimet e seancës së tretë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (35).

Në vijim të seancës, kryesuesja e hapi debatin përkitazi me rendin e punës, duke kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që të deklarohen se a kanë për shtuar ose hequr ndonjë pikë nga rendi i punës? Së pari po theksoj se ne e kemi mbajtur mbledhjen e KPF- në të cilën mbledhje rendi i punës ka qenë i stërngarkuar, prandaj, seancën e kemi ndarë në dy pjesë dhe ky është rendi i punës i propozuar për sot.

Bujar Nevzadi- me sa e di unë kryetari i Komunës është përgjegjësi kryesor, sepse ai ka qenë bartës i listës dhe i ka fituar votat për të marrë pjesë në seanca të KK-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit. Në çdo komunë kryetari i Komunës merr pjesë në seanca, kurse te për 17 muaj kryetari ka qenë dy apo tri herë në seanca dhe kjo është vërejtje dhe kërkoj nga sekretaria që ta evidentoj këtë vërejtje. Mirëpo unë do t' i ngrit disa çështje si të ndryshme në mënyrë që drejtorët të na japin përgjigje në fund.

1. Kërkoj përgjigje për ndërtimet pa leje
2. Pse në rrugët e qyteti dhe periferi të qyteti të gjitha rrugët janë me gropa?
3. Pse ende nuk është bërë meremetimi i Shtëpisë së Kulturës në Përlepnicë
4. Është thënë se do të merren masa për përforsim të Pendës së Përlepncës, kërkoj për ta ditur se çka është ndërmarrë në këtë drejtim ?

Gjithashtu kryetari i Komunës është fyer rëndë me një qytetar, sepse i ka premtuar për t' i dhënë leje për një objekt te Restorant “Raça”, prandaj kërkoj për ta ditur se çka ka ndodhur me atë rast?

Ndërsa atë që e kam thënë për kryesuesen e cila ka thirr konferencë për shtyp për të dhënë dorëheqje, pse nuk iu ka dhënë tenderi për servisim të automjeteve të Komunës, po del e vërtetë, sepse këtë e konfirmojnë dhe shumë aktivistë të LDK-së.

Fehmi Sylejmani- në një takim që kemi qenë me kryesuesen për pikën e parë të rendit të punës përkatësisht për Planin e punës, është marrë qëndrim që kjo të diskutohet më vonë, por nuk i di arsyet pse nuk jemi ftuar fare? Me këtë rast duhet ta dimë se nuk funksionon ajo hallka shumë e rëndësishme e ajo është marrëveshja në mes Kuvendit dhe drejtorive përkatëse të KK-së. Unë në atë takim kam kërkuar që drejtoritë t' ia dërgojnë Planin e punës, kryesueses dhe Sekretarisë së Kuvendit, por kjo nuk ka ndodhur? Për këtë arsyeje në Planin e punës së Kuvendit nuk është përfshirë asnjë nga fushat e kompetencave të Kuvendit, Administrata e Përgjithshme, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale, Inspeksioni, kultura, rina, sporti, të drejtat e njeriut, komunitetet, prokurimi dhe auditimi. Për këtë arsyeje rekomandoj : pasi që një numër i zyrave dhe njësive të cilat nuk janë përfshirë në Planin e punës së Kuvendit, rekomandoj që i njëjti të shtyhet për seancën e radhës së KK-së duke kërkuar që të gjitha drejtoritë t' i dërgojnë propozime dhe të gjitha çështjet të cilat duhet të përfshihen në projekt Planin e punës së Kuvendit edhe atë më së largu deri më 10 maj, atëherë kur po thuhet se do të mbahet KPF.

2. Pasi që projektin e Planit e përgatit dhe e harton KPF-ja i njëjti duhet t' i dërgohet për shqyrtim të gjitha komiteteve, pastaj KPF-së, në mënyrë që KPF ta përgatis projektin për shqyrtim.

3. Plani i punës së KK-së miratohet në seancën e dhjetorit, kurse KPF-ja për çdo muaj duhet ta bëjë analizën e realizmit të planit të punës për vitin 2015 dhe kjo praktikë të aplikohet edhe viteve në vijim.

Komitetet e KK-së deri në fund të muajit maj t' i dorëzojnë planet e punës, por deri më tani sipas informatave që i kemi vetëm KKSJ-ja e ka miratuar Planin e punës dhe në procedurë e sipër është edhe Komiteti i Arsimit. Drejtoritë edhe komisionet përkatëse t' i hartojnë Planet e punës për këtë vit, por sipas informatave që i kemi këtë e ka bërë vetëm drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe e Kadastrit e cila i ka dorëzuar planet e punës deri më tani.

Shfrytëzoj rastin edhe unë t' i shtroj disa çështje, sepse kryetari i Komunës po na mungon dhe mund ta shikoni procesverbalin e seancës së kaluar ku i kam bërë 5-6 pyetje, por asnjë përgjigje nuk më është kthyer! Për këtë arsyeje unë kërkoj që stafi teknik apo kryesuesja e Kuvendit që në fund të çdo seance t' i merr pyetjet dhe t' i dërgojnë drejtorive përkatëse, sepse në fund të seancës drejtorët nuk janë të pranishëm në seancë.

Unë bëj një pyetje lidhur me personalitetin e Xhavit Ahmetit, të cilin e njohin të gjithë, por si duket se nuk e dinë se në Gjilan gjendet një shesh me emrin e "Xhavit Ahmeti". Ky shesh është shëmtuat dhe degraduar, sepse aty është bërë një invazion nga tavolinat e kafiterive. Në vend se t' i heqim të gjitha tavolinat nga ai shesh, aty tërë sheshi është uzurpuar dhe në këtë mënyrë e kanë humbur vlerën dhe autoritetin e këtij personi dhe intelektual.

Në shqetësim është se në raportin për Bashkëpunim Ndërkufitar, kanë kaluar 4 muaj që nga fillimi i punës, por për këtë projekt nuk kemi as një informatë apo raport të punës. Sa i përket gjërave tjera do t' i them nën të ndryshme.

Valnetinë Bunjaku- Rexhepi – në grupin punues, për hartim të Planit të Kuvendit kanë qenë: Valentinë Bunjaku, Arben Maliqi, Jehonë Hyseni, Riad Rashitit, Leonorë Bunjaku, Ibish Ibishi, Fehmi Sylejmani, Jetullah Kadriu dhe Bajram Hasani. Nga i tërë ky ekip vetëm Jehonë Hyseni ka dorëzuar, rekomandime për Plan të punës përkitazi me komitetin të cilin ajo e drejton. Mirëpo ne jemi marrë vesh që të gjitha propozimet duhet të dorëzohen përmes adresës elektorinike, por askush nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe tash nuk është mirë të bëhen akuza ashtu si bën nga z. Sylejmani.

Fehmi Sylejmani- nuk më çuditin këto gjëra, për njeriun të cilin e njoh. Është e vërtetë se kemi qenë në atë takim dhe pyetje e ime e parë ka qenë se cilat janë ato drejtori të cilat t' i kanë dorëzuar planet? Ju jeni përgjigjur asnjë, sepse iu kanë injoruar. E dyta ne e kemi lënë takim për ditën e martë pas dy ditëve, por ju keni thënë se duhet t' i dërgoni ashtu si e kemi paraparë. Unë i kam se cilat pika duhet që duhet të shqyrtohen, por nuk t' i kam dërguar, sepse kur partia e jote dhe drejtorët e tu nuk t' i dërgojnë, atëherë pse unë t' i dërgoj?

Avdyl Aliu- në takimin e fundit të KPF-së të gjithë kemi qenë të pajtimt që të procedojmë me këto pikë dhe atë pa asnjë votë kundër. Mirëpo tash jemi në aprovim të rendit të punës, prandaj nën të ndryshme e kam një pikë e cila do të jetë për:Çështje të funksionimit të Kuvendit.

Riad Rashiti- unë e mora fjalën për disa kërkesa të cilat i kemi adresuar dhe nuk kemi marrë përgjigje? Për këtë arsyeje po i paraqes pyetjet në Kuvend:

-Fillimisht unë e shpreh shqetësimin tim personal lidhur me papërgjegjësinë e organeve komunale për shumicën e pyetjeve të cilat i adresojmë dhe nuk marrim përgjigje asnjëherë, me përjashtim të DUMM e cila është përgjigj, kurse kryetari i Komunës vazhdon të mos kthej përgjigje!

Pyetja e parë të cilin ia kam bërë kryetarit është ajo për fondin humanitar për ndërtimin e shtëpive, sepse nga muaji tetor, është organizuar ajo konferencë janë grumbulluar mjetet dhe asnjëherë nuk kemi marrë informacion se sa është ajo shumë? Mandej sa shtëpi do të ndërtohen? Si do të përzgjidhen familjet dhe shumë çështje të tjera përkitazi me këtë fond?

2. I kemi bërë kërkesë kryesueses së Kuvendit dhe kryetarit të Komunës lidhur me kthimin e ligjshmërisë përkitazi me vendimet e KK të Gjilanit. Mirëpo edhe për këtë edhe pse kanë kaluar më tepër se dy muaj nuk kemi marrë përgjigje. Për këtë arsyeje propozoj që sot të hyjë të rend të punës:

Propozimi për shqyrtimin e vendimit për emërimin e anëtarit të KK-së në ndërmarrjen Publike “Eco-Higjiena”, sepse me Ligjin e Republikës së Kosovës në asnjë ndërmarrje nuk mund të zgjidhet në ndonjë post asnjë kandidatë i cili është nën hetime? Një anëtarë i Komisionit të Aksionarëve nuk mund të zgjidhet një person ndaj të cilit është ngrit aktakuzë e të cilin dokument e posedoj, i cili dokument nuk është dokument i politikës, por institucioneve të drejtësisë dhe ky anëtarë nuk mund të ushtrojë detyrën e vetë derisa është nën hetime? Kërkoj që KK sot ta shqyrtojë këtë vendim dhe së paku ta pezullojë apo suspendojë.

3. Për Zyrën e Prokurimit kam pyetje se çka po ndodh me një numër jashtëzakonisht të madh të aktiviteteve të prokurimit të cilat po anulohen nga OSHP-ja. Raste të tilla ka edhe nga “Agjensioni Antikorrupsion”, prandaj kam pyetje se çfarë masa keni marrë?

4. Disa herë kam kërkuar që të raportoni për dëmet e vërshimeve në Komunë të Gjilanit, sepse kanë ndodhur disa vërshime, por ju asnjëherë nuk na informoni se sa është vlera e dëmeve të cilat iu janë shkaktuar qytetarëve të Gjilanit?

5. Kërkoj nga sekretaria që ta evidentoj kërkesën time dhe ta vlerësoj kryetari i Komunës, sepse ato të cilat po i bëjmë me shkrim nuk po marrim përgjigje! Kërkojmë nga kryetari i Komunës që ta kthejë ligjshmërinë në të gjitha institucionet e Komunës, duke përfshirë arsimin ku ka shkelje ligjore dhe vendime të cilat i anulojnë institucionet Qendrore e të cilat i anulojnë vendimet e arsimit në Gjilan, mandej të Zyrës së Prokurimit dhe të KK-së.

Kërkesa tjetër është që në seancën e radhës kërkoj që kryetari i Komunës ta sjell raportin e Auditorit të Brendshëm për vitin 2014, sepse kryetari po thirret në transparencë, prandaj ta sjell këtë raport në seancë të radhës.

Renan Imam- të na epet një informatë e shkurtër lidhur me kërkesën që e kemi bërë për ndërrimin e anëtarit të KKS-së? Kjo përgjigje të na epet nën të ndryshme?

Arben Malqi-edhe unë i kam disa propozime për pikën nën të ndryshme, prandaj kam kërkesë që drejtorët të qëndrojnë në seancë deri në fund. Së pari të na epet një sqarim lidhur me testin i cili do të mbahet tash me maturantë, e të cilin unë edhe më parë e kam thënë se është mirë që mos të mbahet fare, sepse nuk e ka asnjë vlerë. Me këto mjete më mirë është të blihet ndonjë laborator se sa të epen para kot! E dyta e di që nuk është kompetencë e jona, por sa i përket Kampusit Universitar duhet ta kemi të qartë se çka po ndodh? Studentët më Universitetin “Kadri Zeka”, kushtet i kanë të mjerueshme, prandaj është mirë që drejtori të na i ep disa informata se çka po ndodh? Mandej është një brengë e qytetarëve të Lagjes “Dardania”, sepse në këtë lagje nuk lejohet parkimi i veturave, kurse te Wiva Freshi ku ka frekuencë dhe te Posta e Vogël aty nuk ka ndalesë, prandaj është mirë që të jemi të njëjtë para qytetarëve. Gjithashtu e kam thënë edhe më parë se terrene sportive të mbuluara nuk ekzistojnë askund në botë, sepse ato terrene janë kancerogjene dhe duhet të marrim masa për eliminim të këtyre terreneve.

Edhe një sqarim e dua nga përgjegjësi për kulturë dhe sport përkitazi me terrenin sportiv te varrezat e qytetit i cili terren ka filluar në vitin 2013, janë ndarë afër 600 mijë euro nga BE dhe ka qenë desh të përurohet në vitin 2014 në muajin prill. Ende nuk është bërë përurimi dhe ky terren gjendet në gjysmë të rrugës. Lidhur me këtë terren duhet të shikohet se çka po ndodh?

Nevzad Isufi- sa i përket pikës nën të ndryshme e kam një pyetje: pse Plani i prokurimit nuk paraqitet në KPF dhe pas KPF të miratohet në Kuvend. Dihet se Zyra e Prokurimit sipas Ligjit 52.2 të LVL, bëhet fjalë për KPF-në, por u tha se Plani i Prokurimit iu është dorëzuar Qendrës, por më parë ka qenë deshtë t’i dorëzohet KPF-së pastaj Kuvendit. Nga informatat që i kemi kjo zyrë ka pasur një menaxhim tejet të dobët dhe me defektet serioze të cilin fakt e ka konstatuar edhe KDI, Auditori i Përgjithshëm dhe OJQ-të e ndryshme. Pyetja e ime është cilat janë arsyet e mos dërgimit të Planit të Prokurimit për shqyrtim në KPF dhe kur kjo do të bëhet?

Një pyetje tjetër ka të bëjë me debatin publik përkitazi me projekt-rregulloret për Transparencë. Sa pjesëmarrës ka pasur në shqyrtim publik dhe sa propozime janë marrë parasysht dhe cilat janë

refuzuar? Mandej edhe më tutje nuk kemi rregullore për ndarje të bursave, a është bërë kjo rregullore dhe kur do të bëhet nëse nuk ekziston?

Nuk është raportuar ende për vizitën e anëtarëve të Kuvendit në Turqi dhe cilat janë rezultatet e kësaj vizite, sepse sipas raportit financiar kjo vizitë nuk ka qenë pak e kushtueshme. Gjithashtu kërkoj që të bëhet auditimi i të gjitha kontratave për vitin 2014 e në veçanti për kontratat në vepër?

Fatbardhë Selmani- është deshta ta ngrit një çështje shumë shqetësuese për pikën nën të ndryshme. Në mbledhjen e fundit të Komitetit për Shëndetësi, drejtori i QKMF-së ka raportuar për mbarëvajtjen e kontrollit sistematik të nxënësve në shkolla të Gjilanit. Nga drejtori dhe mjeku tjetër, anëtar i Komitetit për Shëndetësi është theksuar një dukuri shumë e keqe, sepse ka gërvishtje në formë të vijave të drejta të nxënësve nëpër disa shkolla, të cilat nxënësit i shkaktojnë në trupin e tyre ata vetë e të cilat gërvishtje mbesin si shenja të përjetshme. Dukuria është shumë e shprehur, prandaj e lus kryetarin e Komunës dhe të gjithë mekanizmat përgjegjës që të mos presin përfundimin e projektit për t' i qasur kësaj dukurie, sepse mendoj se nëse bëhet vonë kjo dukuri mund të ketë pasojë, sepse në ato plagë mund të depërtojë çdo lloj mikroorganizmi dhe mund të shkaktojnë pasojë shumë të rënda, prandaj duhet të marrim masa sa më shpejtë për eliminimin e kësaj dukurie shqetësuese.

Krenare Latifi- unë e kam një pyetje për drejtorin e arsimit: sa është menduar rritje e buxhetit në arsim pasi që kryetari i Komunës ka premtuar se me rishikim të buxhetit do të ketë rritje në fushën e Arsimit dhe ku e keni paraparë rritjen dhe cilat projekte do t' i realizoni? Ne si opozitë kemi qenë për atë që çdo herë ta trajtojmë me prioritet fushën e arsimit.

Ismet Hajdini- unë e kam një vërejtje, sepse neve në çdo seancë të Kuvendit, pika e fundit po na del pika e parë. Të vazhdojmë me pika të rendit të punës dhe kur të vijmë nën të ndryshme, atëherë diskutojmë.

Leonorë Bunjaku- të gjithë jemi në dijeni se këto ditë institucionet edukativo-arsimore po ballafaqohen me probleme të natyrave të ndryshme. Në mesin e këtyre çështje është edhe një urdhëresë nga DKA, ku thuhet se për çdo mungesë të arsyeshme apo të paarsyeshme do të ketë ndalesë në paga! Ju lus z. drejtor i Arsimit se mos ka të bëjë me ndonjë gabim teknik apo ne nuk po mund ta kuptojmë?

Arijetë Rexhepi – unë për pikën nën të ndryshme i ka disa pyetje; Drejtorit të Arsimit i kam parashtruar pyetje me 3 mars të këtij vit, por ende nuk kam marrë përgjigje, por edhe nga DUMM kam kërkuar në tetor të vitit 2014 i kam bërë disa pyetje për të cilat asnjëherë nuk kam marrë përgjigje dhe çështja ka të bëjë me objektin i cili është duke u ndërtuar afër Shkollës "Thimi Mitko", por dhe nga drejtori i Kadastrit kam kërkuar listën e uzurpatorëve të pronave komunale, por nuk kam marrë përgjigje. Gjithashtu nën të ndryshme do ta ngrit edhe një çështje që ka të bëjë me kryesuesen dhe për Zyrën Ligjore, për mënyrën e zëvendësimit të anëtarëve të komiteteve e cila bëhet në mënyrë automatike për pa ardhur emrat në Kuvend.

Isa Agushi- nuk e di për të satën herë po e theksoj çështjen e bexhave, sepse për 16 muaj që jeni në pushtet dhe nuk i keni bërë bexhat. Ka përgjegjësi kryesuesja për këtë çështje, sepse kjo punë nuk është kryer.

Çështje tjetër; çka është duke ndodhur me Kompaninë Eco- Higjiena? Ku është komisioni i aksionarëve cili është formuar nga KK, por asnjëherë nuk kanë raportuar në KK. Kërkoj që të formohet një komision i veçantë për të vërtetuar se a janë përmbushur obligimet në realizimin e investimeve sipas marrëveshjes me PPP-në?

Për kolegun Riad i cili tha dikush nga anëtarët e komisionit ka aktakuzë, por aktakuzë mund të bëjë çdo kush dhe kjo nuk paraqet problem, por zotëria për të cilin flet Riadi, ka dalë i pastër nga të gjitha gjykatat dhe e ka vendimin për t' i kthyer në vend të punës, por Kompania nuk e lejon për të hyrë brenda. Kjo as në Afrikë nuk ndodh! Kompaninë Eco –Higjena e kanë privatizuar disa njerëz dhe e kanë bërë private, por flasim për 49%. Aty ka shumë keqpërdorime dhe nuk ka kush që i del në skaj kësaj pune?

Riad Rashiti-z. Agushi e thash në fillim se nuk po e themi ne as nuk po e akuzojmë ne! Ne secili mund t' i bëjmë aktakuzë njëri tjetrit, por është Prokuroria e cila vendos se duhet dikujt t' i ngritët aktakuzë apo jo? Ne e kemi një dokument i cili është i protokolluar i vulosur nga Gjykata Themelore dhe është aktakuzë e ngritur.

Jetullah Kadriu – unë e di se në kur kemi biseduar për planifikimin e Planit të punës së Kuvendit ne jemi marrë vesh që të futet edhe kërkesa e ime e cila ka të bëjë me problemet e qytetarëve të Kosovës Lindore. Mirëpo në KPF nuk është debatuar dhe nuk ka kaluar kjo çështje. Nën të ndryshme e kam një kërkesë për funksionalizmin e çështjes së të burgosurve politik?

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me vërejtjet dhe sugjerimet e rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet rendi i punës ashtu si është në material dhe të vazhdohet me punë?

Aprovohet rendi i punës me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 1 ishte kundër kurse të tjerat abstenime.

Procesverbali

Aprovohet procesverbali pa vërejtje me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit (35).

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2015

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – ne e kemi dorëzuar një Plan për vitin 2015, në të cilin ka mundësi përmirësimi dhe ku nevojë për të inkorporuar edhe pika shtesë. E sqarova në fillim se e kemi thirrë grupin punues, kemi rekomanduar që në adresa elektronike të dorëzohen propozimet, por nuk ka ardhur asnjë propozim. Ky është projekt plani, por gjatë kohës në vazhdimësi kemi mundësi përmirësimi.

Sahit Abazi – arsyeja pse Planin e punës së Kuvendit e kemi mbështetur në Kuvend është se ka kaluar gati gjysma e vitit, kurse ne jemi pa plan. Mirëpo në ndërkohë tash përfaqësuesi nga LVV kërkon që të shtyhet aprovimi i këtij plani dhe normalisht e mbështesim këtë kërkesë të tij, sepse drejtoritë nuk kanë sjell plan pune. Ne tash nuk e dimë në emër të kut të bëjmë plan pune, ngase drejtoritë nuk i kanë planet e gatshme. Mund t' i keni drejtoritë, por nuk e kemi në këtë dokumentin që e kemi sot ne. Për këtë arsyeje edhe ne kërkojmë që ko të shtyhet dhe sigurisht që secila drejtori duhet ta ketë një plan të punës i cili duhet të harmonizohet me planin e Kuvendit. Ajo e cila do të kërkojë të bisedohet nën të ndryshme, por pasi sot është në Gjilan kryeministri ju si kryesuese në takim me kryeministrin sot ta debatoni çështjen e Lumit Mirusha, sepse ky pushtet aktual ka premtuar se kjo punë do të zgjidhet moti, por po shihet se kemi vetëm ngecje. Ta shfrytëzoni këtë vizitë të kryeministrit dhe t' i mundësohet zbatimi i këtij projekti deri në fund sa më parë.

Nevzad Isufi- ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se jemi vonuar mjaft për ta aprovuar planin e punës së Kuvendit, por për këtë pjesë e cila na ka mbetur nuk duhet ta bëjmë ashtu shkel e shko, sepse në

pjesën e parë vetëm është përshkruar plani i punës. Për këtë arsyeje unë edhe në KPF e kam thënë dhe e kam propozuar, se këtij Plan, i mungojnë shumë gjëra, prandaj pjesën që na ka mbetur nuk do të thotë ta bëjmë vetëm sa për formalitet. Për këtë arsyeje edhe unë jam që ky Plan i punës të përgatitet për seancën e ardhshme dhe deri në atë kohë edhe drejtoritë edhe sektorët e tjerë t' i dërgojnë propozimet e tyre dhe ta bëjmë një plan me përmbajtje dhe formë si i duhet Kuvendit. Këto gabime të shumta, por ato më të rënda janë gabime edhe në vite si: raporti i Arsimit për vitin 2013-2014, në vend se të jenë për vitin 2014-2015 dhe plotë vërejtje të tilla.

Unë kërkoj që mos të bëjmë akuza, por këtë pjesën e mbetur ta bëjmë ashtu si duhet dhe plani të përputhet me gjërat të cilat do të parashihen.

Avdyl Aliu- unë nuk po e kuptoj arsyen e pishmnallëkut të kolegëve dhe nuk e besoj se edhe ata kanë arsyeje për këtë pishmanllëk. Nuk e di pse janë pishman nga mbledhja e KPF-së deri më sot (një javë e plotë). Këta njerëz edhe këto duar i kanë pasur po atë ditë të cilat i kanë ngrit për ta sjell këtë plan në Kuvend. Është për t' u çuditur pse sot të njëjtat duar ngritën dhe thonë jo nuk e duam këtë plan! Do ta kisha pasur dëshirë për ta ditur, pse veprojnë në këtë mënyrë, por nuk e dinë as vetë pse veprojnë kështu? Plan i KK-së është i bazuar në ligje për LVL, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit dhe akteve tjera nënligjore. Sot para nesh e kemi një plan i cili është plan orientues në vija të trasha nuk është i përkryer, por është një plan i mirë dhe i bazuar në një kornizë logjike në të cilin plan janë planifikuar etapat dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit. Me këtë plan synohet të arrihen objektivat për vitin 2015 si mbajtja e seancave në të dy gjatëmuorët e vitit.

Plani i punës do ta ndihmojë dhe lehtësoj në masë të madhe punën e Kuvendit, kurse kolegët mund ta kenë një pasqyrë për punë dhe aktivitete të planifikuara për vitin 2015 dhe që kanë të bënë me interesat e qytetarëve. Është përgjegjësi e kryetarit, kryesueses së Kuvendit si dhe shefit të Njesisë së Kuvendit për t' i realizuar këto objektiva, sepse ky plan kërkon bashkëpunim dhe bashkëveprim me ekzekutivin e Komunës. Unë këtu i kam planet për vitin 2012 dhe 2013 e të cilat mund t' i shihni, por është i 2014 dhe 2015 dhe të gjitha janë të njëjta, sepse Kuvendi bën punë të njëjta. Unë kërkoj që të miratohet ky Plan i punës!

Sealmi Xhemajli- ne e kemi thënë në KPF se ky plan duhet aprovuar dhe jam për atë që ta miratojmë, në emër të asaj që mund ta hartojmë një plan të përsosur me qëllim që ta kemi një Kuvend funksional. Unë jam për atë që këtë plan ashtu si është ta aprovojmë me mundësi të kompletimit pas propozimeve të sjella nga drejtoritë përkatëse të KK-së. Ne duke tentuar që ta bëjmë një plan të përkryer, ne vetëm po humbim kohë dhe po bëhet shtyrja për seancat e tjera, por i tillë si është ka mundësi të plotësohet. Unë jam që ta aprovojmë sot, me sugjerimet të cilat i propozova.

Jehonë Hyseni- sa i përket hartimit dhe miratimit të Planit të KK-së është e vërtetë se kemi debatuar, por pasi që sot e kemi një plan para vetës duhet ta miratojmë me plotësimin e disa propozimeve. Unë i kam edhe disa propozime e të cilat duhet të figurojnë në këtë plan si: manifestimi tradicional i "Flakës së Janarit" për vitin 2015, Planifikimi i buxhetit për vitin ardhshëm si dhe miratimi i këtij buxheti. Ndërsa sa i përket raportimit të ndërmarrjeve publike si "Eco -Higjiena" dhe Stacionit Autobusëve "Kosovatrans", mendoj se këto ndërmarrje duhet të raportojnë në fillim të vitit për vitin paraprak, sepse edhe ligji i obligon që këto ndërmarrje publike të raportojnë në Kuvend. Në nëntor mendoj se duhet të hartohet plani për vitin 2016, kurse në muajin dhjetor të miratohet ky plan i punës dhe të merret vendimi për orarin e mbajtjes së takimeve të seancave dhe takimeve të komiteteve të KK-së.

Bajram Hasani- unë po ndërlidhem me fjalën e kolegut Isa Agushi dhe mendoj se PDK po e qeverisë qeverinë, por pse po e qeverisë e Gjilanin nuk po mund ta kuptoj!

Unë mendoj se pas debatit i cili u zhvillua për Eco- Higjenën, unë mendoj se kryetari i Komunës duhet ta shfrytëzoj autoritetin e vetë dhe duhet t' i kontrollojë ato këshilla (borde) dhe të shikojë se çka nuk është në rregull!

Sa i përket Planit të punës, unë jam anëtar i këtij komisioni, mirëpo për shkaqe personale nuk kam pasur mundësi të marrë pjesë në atë komision, por propozoj që të kaloj ky plan në vija të trasha dhe pas disa ditëve komisioni të takohet edhe njëherë dhe t' i shqyrtojë, propozimet e drejtorive përkatëse të cilat duhet t' i dërgojnë dhe në seancën e radhës të kalojë si i kompletuar.

Riad Rashiti- edhe unë kam qenë anëtar i këtij komisioni, por edhe unë për disa arsyeje nuk kam pasur mundësi të jem në këtë takim, por në këtë seancë do t' i jap disa propozime: fillimisht plani në përmbajtje është i njëjtë me vitin paraprak, mirëpo i kam disa vërejtje rreth përmbajtjes, sepse nuk është në harmoni me trajtimin e problemeve me kohë të cilat i përmendi më parë kolegja Jehonë.

Është e vërtetë se ne kemi kërkuar që të në këtë plan të përfshihet raporti i manifestimeve tradicionale, por gjithashtu e kemi parë se në muajin nëntor është raporti i dy kompanive publike , mirëpo kjo është venë dhe nuk e kuptoj pse në nëntor, por kjo duhet të ndodhë në fund të prillit, sepse më 15 maj, secila kompani është e obligueshme që ta miratojë raportin financiar për vitin e kaluar. Për këtë arsyeje ky raport në këtë seancë ka qenë deshtë të jetë gati ose në seancën e radhës. Në raport kishte mjaft gabime të cilat ishin teknike dhe ka formulime skandaloze. Një rast i tillë është kur thuhet : rregullorja për qen dhe mace, është një formulim skandaloz, sepse duhet gjetur tjetër term dhe jo kështu si thuhet, sepse nuk i duhet rregullorja qenve dhe maceve.

Ne propozojmë që në këtë Plan në muajin qershor të përfshihet edhe raporti i Auditorit të Brendshëm. Është mirë që të planifikohet që së paku nga një drejtori të raportojë në çdo seancë, sepse në raportet të cilat po na vijnë në gjashtë mujor, ne nuk po jemi në gjendje të dëgjojmë punën dhe rezultatet e drejtorive komunale.

Nevzad Isufi- u tha se ne i kemi ra pishman këtij propozimi nga mbledhja e KPF-së, por ne nuk i kemi ra pishman askujt dhe për asgjë, sepse të gjitha pikat e rendit të punës të këtyre dy kuvendeve që po mbahen dhe i cili do të mbahet janë futur në gjashtë mujor të planit të punës së Kuvendit.

Kjo është e vërtetë dhe nuk i kemi ra pishman asgjë! Nëse punoni kështu le ta bani me shëndet, por unë nuk po mund të rri indiferent për pa dhënë vërejtje konkrete. Këtu e keni bërë vetëm një kopje të vitet 2013 dhe 2014, por as vitet nuk i keni përmirësuar. Në plan shkruan raporti financiar për vitin 2013, informatë për përfundimin e vitit shkollor 2013 dhe 2014 dhe plotë gabime të tilla.

Propozoj që në qershor të futet informata për korrije-shirje për ta ditur si ka përfunduar kjo punë shumë e dobishme. Po ashtu në muajin nëntor të bëhet propozimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin e ardhshëm. Gjithashtu në dhjetor të jetë edhe raporti i punës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe projektet e realizuara për vitin 2015. Plani i punës për vitin 2016 duhet të aprovohet në dhjetor të këtij viti. Rishikimi i buxhetit duhet të bëhet në qershor, por në këtë plan nuk është i paraparë. Këto ishin vërejtjet e mia dhe është e juaja se a dëshironi t' i përmirësoni apo jo?

Arben Maliqi- unë kam qenë pjesë e këtij komisioni, por parafolësit e thanë shumë mirë se është e vërtetë se ka gabime ka të meta, ka pasur vonesa dhe në një mënyrë apo tjetër nuk është e përkryer çdo gjë? Mirëpo u përmend edhe nga përfaqësuesi i AAK-së se gabime ka pasur edhe më parë dhe nuk mund të parashihet ashtu si duhet asgjë. Unë iu lus që ta aprovojme ashtu siç e tha Selamiu dhe t' i kalojmë këto që janë më të rëndësishme për neve, kurse gjatë punës i bëjmë përmirësimet.

Avdyl Aliu- fjala e anëtarit të Kuvendit në njëfarë mënyre është edhe fjalë e Kuvendit, prandaj unë po kërkoj për ta përmirësuar në llopsues të cilin e bëri një koleg pak më parë dhe mos të dal ajo si fjalë e Kuvendit dhe të thuhet çka ju duhet rregullorja për qentë dhe macet? Unë këtë po e përmirësoj dhe po e them se rregullorja i duhet edhe qenve edhe maceve dhe nëse dikush e lexon e vëren se i duhet rregullorja edhe qenve edhe maceve, sepse janë qenie të gjalla, por më shumë iu nevojitet atyre të cilët i kafshojnë qentë.

Pas diskutimit të z. Avdyl Aliu, kryesuesja i liron, anëtarët e Kuvendit në një pushim prej 5 minutave.

Seanca i vazhdon punimet pas këtij pushime me pikën e parë të rendit të punës

Bujar Nevzadi – unë po e ngrit një shqetësim, sepse gjatë pushimit shefi i grupit të LDK-së iu kërcënua anëtarit të grupit të PDK-së, z. Riadit, por përmes tij më është kërcënuar edhe mua! Unë nuk dua të merrem me këtë njeri vetëm po i tregoj se njeriut të gjallë në këtë tokë nuk i frikohem dhe nuk ka nevojë ky njeri të na kërcënohet neve. Kërcënon vetëm ai njeri i cili nuk argumente të fjalës, por tenton me argumente të forcës të kërcënoj. Mirëpo këtë le ta harrojë, sepse nuk i ka hije asnjë anëtar i Kuvendit, por aq më pak Gjilanit. Unë kërkoj që ky njeri ta merr fjalën dhe të kërkoj falje për sjelljen e tij që e bëri ndaj kolegëve.

Riad Rashiti- në çdo seancë që po mbajmë po ndodh ndonjë kërcënim, rrahje dhe është çudi se po tentohet edhe në Kuvend dikush ta bëjë atë dhunë! Mirëpo këtë nuk mund ta bëni! Është për keqardhje sjellja e përhershme e shefit të grupit të LDK-së, sepse vazhdimisht merret me thënie të ndryshme banale, ofenduese etj. Në çdo seancë ky person përpiket të fyejë diçka, të shajë, mirëpo ju e keni bërë shef dhe ai të vazhdojë në këtë formë. Mirëpo ai duhet të harrojë se me këtë sjellje nuk mund të vazhdojë të bashkëpunojë me ne, sepse ne nuk do t'ia lejojmë. Në vazhdim të fjalës së tij z. Rashiti i përmendi disa raste kur ka pasur rrahje dhe burgosje të zyrtarëve komunal gjatë kësaj qeverisje. Pse nuk përmendni pse është arrestuar zyrtari komunal, pse është arrestuar gabimisht nga Policia e Kosovës. A ka ndonjë komision disiplinor për sjellje të zyrtarëve e të cilat sjellje i bëjnë vetëm rrugaçët dhe nuk i takojnë në asnjë mënyrë zyrtarëve. Ju thirrreni në akademi, por akademia e juaj është vetëm fyerja dhe sharja dhe ofendimet.

Avdyl Aliu- të gjithë ishim këtu, prandaj po iu pyes se a pat rast që unë e kam fyer dike gjatë fjalës sime për dy herë sa e mora fjalën? Nëse qëndron kjo le të del dikush dhe të thotë se cilin fyerje dhe sharje e kam bërë. Zakonisht gjatë pushimeve ne bisedojmë njëri me tjetrin, por nëse dikush frikohet nga hija e vetë, unë nuk kam çka t'ia bëjë. Unë bisedova shumë thjeshtë dhe shumë mirë dhe nuk iu kam kërcënuar askujt. Mirëpo nëse dikush e merr kërcënim praninë fizike timen këtu, unë nuk kam çka të bëj!? Mua 900 vota më kanë sjellë këtu dhe nuk kam çka të bëj? Ju nëse kërkon që unë fizikisht mos të jem këtu, unë nuk kam çka të bëj. Unë askënd nuk e kam kërcënuar dhe as shantazhuar dhe nuk kam tjetër se çka të them?

Riad Rashiti-po e potencoj edhe njëherë se nuk e kemi nevojën as nivelin për t'u frikuar prej këtij niveli të njerëzve të këtill dhe të kujtdo qofshin. Ky nuk e quan kërcënim, por kur unë bisedoja me Isa Agushin dhe kisha dokument në dorë, z. Avdyli ma merr nga dora dhe e hedh në tokë, si konsiderohet kjo? A është ky kërcënim apo jo?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi –ju lus të keni konsideratë, sepse të gjithë jeni shokë, por se çka flitet gjatë pauzës, ne nuk mund askënd ta ruajmë. Unë nuk besoj se ka njerëz të atij niveli që e kërcënojnë njëri tjetrin? Kërkoj mirëkuptim dhe iu lus ta ndalni debatin rreth kësaj çështje!?

Bujar Nevzadi- ishte prezent Isa Agushi dhe ndonjë anëtar tjetër, por ne nuk kemi nevojë të frikohemi prej hijes sonë. Unë e thash se njeriut të gjallë që ekziston nuk i frikohem. Ky shef tash po i ndërrohet fjalët, sepse duhet ta thotë se e kërcënova dhe Riadin edhe Bujarin, por gabova dhe jo t'ia ndërroj fjalët në çdo minutë.

Në fund u zhvillua një debat mjaft i ashpër në mes të z. Avdyl Aliu, Riad Rashiti dhe Bujar Nevzadi të cilin debat me shumë përpjekje, kryesuesja e ndërpreu.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me pikën e parë të rendit të punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet kjo pikë?

Aprovohet pika e parë(1) e rendit të punës : Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2015, me plotësime dhe vërejtje të cilat u bënë, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 6 ishin kundër, të tjerët abstenuan.

Pasi që në Gjilan ishte në vizitë kryeministri i Kosovës, punimet e seancës në vijim i udhëhoqi anëtari më i vjetër i Kuvendit, z. Zijadin Maliqi, sepse kryesuesja kishte agjendë tjerë në takim me kryeministrin e Kosovës.

Zijadin Maliqi-dy drejtorë, ai për financa dhe ai Kadastrit nuk janë prezent, sepse edhe këta janë në takim me kryeministrin, por të cilët duhet të japin sqarime për pik 2, 3 dhe 4 të rendit, propozoj që të vazhdojmë me pikën 5 të rendit të punës, kurse në ndërkohë ata drejtorë do të vijnë dhe do të procedojmë me këto pika të rendit të punës.

5. Projekt Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transparencën në Komunën e Gjilanit, 01.Nr.2681 i datës 12.03.2008

Hevzi Matoshi – Duke pasur parasysh se është nxjerrë udhëzimi administrativ nr. 05/2013 për transparencë në komuna që në nenin 9 të saj përcaktohet obligimi për Kuvendin e Komunës që të miraton rregulloren komunale për transparencë në Komunë.

Në kuptim të kësaj Kryetari i Komunës në pajtim me nenin 58 pika h) dhe në zbatim të nenit 17 pika s) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, inicion dhe i propozon Kuvendit të Komunës që të miratojë

**RREGULLOREN
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR
TRANSPARENCË NË KOMUNËN E GJILANIT 01 NR. 2681 DT. 12.03.2008**

Qëllimi i miratimit të kësaj projekt-rregulloreje është harmonizimi i rregullores aktuale me udhëzimin administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komuna dhe harmonizimet kanë të bëjnë me nenet si në vijim:

Në të gjitha nenet e rregullores bazë, fjalja “dokumente zyrtare” do zëvendësohet me fjalinë “dokumente publike” në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të [Ligjit nr. 03/1-215 për qasje në dokumente publike](#).

Të gjitha dokumentet e komunës për të cilat mund të jenë në dispozicion të publikut, qasja në to do të bëhet “përmes zyrtarit të zyrës për informim”.

Kërkesat ose petitionet duhet të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës në afat prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit në Komunë kurse njoftimi për vendimin e marrë bëhet në afat prej 15 ditësh.

Në pajtim me këtë projekt-rregullore dhe me nenin 68.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të Statutit të Komunës, sanksionohet rregulla që Komuna detyrimisht mban të paktën dy tubime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm.

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. **05/2013** për Transparencë në Komuna, është mbajtur edhe dëgjimi publik për këtë projekt- rregullore me datën **10.02.2015 (e martë) dhe me dt. 13.02.2015 (e premte)** në ora **13:30** me qytetarë, shoqata, grupet të interesit dhe institucione të komunës ku janë evidentuar të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e dala nga dëgjimi publik. në fund propozoj që këto propozime dhe ndryshime të aprovohen në Kuvend.

Zijadin Maliqi-kjo rregullore ka ndryshime në rregulloren ekzistuese për të cilën janë bërë edhe debate publike, kurse në KPF unanimisht ka kaluar, por nëse ka dikush ndonjë vërejtje mund ta merr fjalën.

Fehmi Sylejmani – edhe unë e di në çfarë mënyre se Zyra Ligjore është sponzore e debatit publik, prandaj e shfrytëzoj rastin për ta bërë një pyetje: a është zbatuar neni 7 i Udhëzimit administrativ,

nr. 05/2013 për transparencën si dhe paragrafët 3 dhe 7 ? Mandej kam një pyetje shumë konkrete a ekziston procesverbal për mbajtjen e debatit publik? Nëse keni procesverbal gjatë debatit publik, na i thoni se cilat kanë qenë vërejtjet e qytetarëve në atë debat publik?

Hevzi Matoshi – siç a pat gjatë elabarimit në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një harmonizim vetëm sa i përket terminologjisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin për qasje në dokumente zyrtare.

Është respektuar plotësisht neni 7 dhe dispozitat e Statutit dhe të rregullores aktuale që e kemi dhe të gjitha ato që janë thënë në debat janë marrë në shqyrtim, por me këtë rast kemi të bëjmë më tepër me një harmonizim të kësaj rregulloreje.

Nevzad Isufi- unë desha vetëm te neni 5 ku propozohet që afati të jetë prej 30 -60 ditë, kur është fjala për çështjen e cila ka të bëjë me përgjigjen. Mua më duket se ndoshta 60 ditëshi nganjëherë mund të jetë i vonuar, prandaj mendoj se 30 ditë janë optimale për një përgjigje, sepse nuk do të ketë përgjigje të tilla për çdo ditë.

Hevzi Matoshi- ky afat nuk ka dal nga Komuna, por ashtu është përcaktuar në Udhëzimin administrativ.

Nuk pati debatus të tjerë, kurse kryesuesi kërkon që të aprovohet pika 5 e rendit të punës?

Aprovohet pika 5 e rendit të punës: Projekt Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transparencën në Komunën e Gjilanit, 01.Nr.2681 i datës 12.03.2008, me 16 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan nga votimi

6. Projekt Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukurit që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre

Hevzi Matoshi- qëllimi i miratimit të kësaj projekt-rregulloreje do të jetë përcaktimi i kushteve për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve- të mitur dhe zhvillimin e tyre dhe kushtet për të cilat personat fizikë, organizatat tregtare dhe shërbyese, duhet t`ju përmbahen gjatë ofrimit të shërbimeve të tyre kur janë në pyetje fëmijët siç janë përcaktuar me këtë projekt-rregullore.

Në projekt-rregullore janë përcaktuar edhe dispozitat **ndëshkuese dhe gjobat** orientuese **për personat** juridik-subjektet afarist dhe personat përgjegjës fizik të tyre, nëse në lokalet e tyre shesin ose shërbejnë pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nenit 3 paragrafi 1,3,4,5 dhe 6 të kësaj Rregulloreje, për kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë të njëjtë siç janë të përcaktuara në nenin 103 pika (l) të Ligjit nr. 2004/16 mbi veprimtarin hoteliere dhe turistike, ndërsa personi fizik që shkel dispozitat e nenit 3 paragrafi 1,3,4,5 dhe 6 të kësaj rregulloreje, dënohet me gjobë mandatore prej 200€.

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, dhe në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. **05/2013** për Transparencë në Komuna, është mbajtur dëgjimi publik me datën **10.02.2015 (e martë)** në ora **13:30** me qytetarë, shoqata, grupet të interesit dhe institucione të komunës ku janë evidentuar të gjitha vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e dala nga dëgjimi publik.

Shpresë Kurteshi- projekt rregullorja cila është propozuar për mbrojtjen e fëmijëve, pa dyshim se është një ndër aktet më se të domosdoshme, sepse deri më tash një akt i tillë i ka munguar Komunës. Ne si LDK mendojmë se kjo rregullore përmban elemente të rëndësishme, por aty ku vlerësoni se është e paplotësuar dhe ka ndonjë mangësi ekziston mundësi për ta kompletuar edhe më mirë. Rëndësia e kësaj është që ne ta respektojmë dhe zbatojmë ashtu siç është paraparë. Unë uroj që nga çasti i hyrje në fuqi të këtij dokumenti, organet kompetente duhet të kujdesen që ky dokument të

zbatohet në tërësi, në mënyrë që të miturit dhe të rriturit të jenë të mbrojtur nga dukuritë që e dëmtojnë shëndetin e tyre.

Mevlyde Zejnullahu- edhe unë e vlerësoj shumë hartimin e kësaj rregulloreje, por unë po e paraqes një rast i cili ka ndodhur jo më larg se dje, sepse në një kafiteri e cila gjendet afër kompleksit të shkollave i kam vërejtur hiq më pak se 27 lloje të pijeve alkoolike. Ajo kafiteri ka qenë përplot e mbushur me nxënës të cilët i kam vërejt edhe pse nuk jam vizitore e kafiterive. Të gjitha këto pije alkoolike (27), shërbehen me një çmim minimal. Organet kompetente duhet të marrin masa dhe ta ndalojnë shërbimin me pije alkoolike në kafiteri të cilat gjenden afër kompleksit të shkollave.

Jehonë Hyseni- mendoj se kjo rregullore ka për qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumimi i alkoolit, duhanit dhe narkotikëve të ndryshëm. Mirëpo këto dukuri devijuse janë në rritje e sipër në shoqërinë tonë, prandaj një rregullore e tillë mendoj se është e mirë për parandalimin e dukurive të tilla e që ndikojnë keq në shëndetin e të rinjve. Mirëpo në këtë rregullore mendoj se duhet të jetë edhe një nen tjetër dhe të çdo frekuentues i këtyre kafiterive të kenë një dokument identifikimi për t' u verifikuar moshën e personave të cilët hyjnë në këto lokale.

Leonorë Bunjaku- jemi të vetëdijshëm të gjithë se kjo rregullore është shumë e qëlluar dhe shumë e dobishme, por shtrohet pyetje sa mund të ketë zbatim në praktikë? Fillimisht këtyre fëmijëve duhet t' iu sigurohet ndriçimi publik në Komunën tonë, siguria e fëmijëve nëpër shkollë, siguria nga qentë endacak , pastaj vjen parandalimi i dukurive negative si pirja e duhanit, alkoolit dhe narkotikëve të tjerë. Mirëpo në veçanti vlen të theksohet një dukuri tejet negative e cila është në rritje e sipër e që janë vjedhjet. Dukuritë e vjedhjeve është në rritje e sipër, sepse në të kaluarën nga informatat e Policisë së Kosovës në një lagjeje ka qenë vetëm një i mitur i cili ka kryer një vjedhje, por tani kemi fëmijë i cili i ka bërë 200 vjedhje. Shtrohet pyetja se çka ndërmerret me këta fëmijë, kush merret me këta? Rasti zbulohet, bëhet intervista, kurse kryesi i veprës lirohet në shtëpi ! A ka ndonjë institucion i cili do t' i ndihmojë fëmijëve që këto dukuri negative që njëherë përgjithmonë këto dukuri negative të trajtohen ashtu si duhet? Kjo rregullore është e mirëseardhur, por duhet parandaluar këto dukuri me të cilat po ballafaqohemi në Komunën tonë dhe më gjerë.

Selvetë Shurdhani- kur e kam lexuar materialin dhe posaçërisht Rregulloren për të miturit e cila i trajton dukuritë që e dëmtojnë shëndetin e tyre, secili prej neve jemi ndier mirë. Mirëpo unë po e bëj një pyetje: “ A është më e fuqishme, rregullorja apo ligji”? Te ne problemi nuk është te hartimi i rregulloreve, por është te zbatimi i ligjit. Për derisa shkelet ligji me dy këmbët, sepse vetë në KK nuk zbatohet Ligji për pirje të duhanit, sepse 50% të anëtarëve të Kuvendit e pinë duhanin në lokalet e Kuvendit (korridore), atëherë çka presim ne për zbatim të rregullores për mbrojtje të të miturve? Unë mendoj se mekanizmat e zbatimit të këtij ligji duhet të jenë më të ashpra, sepse për ndryshe ashtu siç janë plotë ligje në letër dhe nuk implemetohen ashtu dyshoj se edhe kjo rregullore do të mbes vetëm në letër. Dëshiroj dhe shpresoj që kjo rregullore mos të mbesin vetëm në letër.

Jonuz Hasani- unë e kam një shqetësim lidhur me këtë rregullore të cilën e përkrahi, por shqetësimi është se sa do të jetë e zbatueshme kjo rregullore është pikëpyetje. Shqetësimi është te shkolla e fshatit Velekicë, sepse ka informacione se për rreth objektit të kësaj shkolle konsumohet alkooli, sidomos nga adoleshentët.

Këta fëmijë në sasi të mëdha i përdorin disa barëra narkotike, por ka prej tyre që bartin me vete edhe mjete të mprehta, por ka raste që bartin edhe armë të zjarrit. Kërkoj që në këtë shkollë të jetë një përkujdesje më madh, sepse qytetarët e asaj pjese janë në gjendje të rëndë.

Arben Mehmeti- kjo është një rregullore që edhe më parë e kemi pasur, por nuk është zbatuar asnjëherë! Për këtë arsyeje është mira të rishqyrtohet çështja e kësaj rregulloreje dhe besoj se nuk është keq që kjo rregullore të rikthehet në Komitetin e Arsimit. Këtë po e them, sepse ne në Komitet

kemi biseduar për çështje të kafiterive në atë pjesë të qytetit(kompleks të shkollave) dhe ka qenë një rekomandim që ose të zhvendosen ato kafiteri ose t' i ndalohet veprimtaria, për qëllime për të cilat është nxjerr kjo rregullore. Nëse ne tash i vizitojmë ato kafiteri do të shohim se janë të mbushura ato kafiteri me profesorë dhe nxënës. Edhe kjo rregullore e cila e rregullon çështjen e nxënësve është për mua jo serioze nëse nuk e plotësojmë edhe me dispozita për sjelljen e mësimit dhënësve, sepse një numër i konsiderueshëm i tyre ndoshta edhe e stimulojnë këtë dukuri, sepse janë edhe pronarë të atyre kafiterive në atë pjesë ! Dënimi prej 50- 200 € është një dënim simbolik dhe nuk mund të presim zbatim të kësaj rregulloreje në asnjë mënyrë.

Unë propozoj që në këtë rast t' i propozohet Komitetit për Arsim në bashkëpunim me DKA që ta plotësojmë dhe ta nxjerrim një rregullore më kuptimplote dhe e cila mund të zbatohet. Në të kundërtën kjo rregullore nuk do të zbatohet, kurse ne mund të themi se kemi nxjerr një rregullore në letër.

Zijani Maliqi- kjo është rregullore për Mbrojtje të të miturve, janë evidente të gjitha ato që i tha z. Arbeni, janë edhe te punëtorët e arsimit, por është rregullorja e veçantë e cila e rregullon përgjegjësinë e punëtorëve të arsimit.

Jashar Jashari- si të gjithë edhe unë e përkrahi këtë rregullore për mbrojtjen e fëmijëve, sepse fëmijët shumicën e kohës e kalojnë pranë kafiterive afër shkollave. Unë në mandatin e kaluar e kam pasur një rekomandim të Kuvendit që ato kafiteri që janë afër shkollave ose të bëhet ndërrimi i veprimtarisë së tyre ose të bëhet dislokimi i tyre. Mendoj se me një rregullore shumë të thjeshtë kjo çështje mund të rregullohet, sepse ne e kemi bërë dislokimin e lojërave të fatit (kazinove) e të cilat janë dislokuar 500m larg institucioneve arsimore, prandaj edhe kjo problematik shumë lehtë mund të rregullohet. Duhet pasur pra kujdes që kafiterit mos të jenë shumë afër shkollave fillore dhe të mesme.

Fehmi Sylejmani- edhe unë pajtohem plotësisht me propozimin e doktor Jasaharit, por edhe të gjitha propozimet e tjera ishin të nivelit më të lartë të mundshëm. Mirëpo më parë ka qenë një vendim që mos të shërbehen fëmijët, me pije alkoolike, mirëpo kjo nuk ka pasur efekt pozitiv. Kjo formë duhet të hiqet dhe mos të propozohet, sepse ka dështuar. Mirëpo këtu duhet ta kemi edhe një gjë parasysh, sepse me statut është shuar drejtoria e Inspeksionit, prandaj kush do t' i kontrollojë këto kafiteri? Ku janë inspektorët sanitarë? Unë sipas informatave që i posedoj, inspektor sanitar nuk ka Komuna e Gjilanit! Unë po e përsëris edhe njëherë se pajtohem plotësisht me propozimin e dr. Jasharit.

Riad Rashiti- unë mendoj se kjo rregullore ka lëshime dhe ka gabime dhe plotësisht pajtohem me propozimin e Arben Mehmetit, sepse edhe pse ekziston një rregullore tjetër për mësime dhënësive është mirë që kjo të ndërlidhet me atë rregullore. Unë mendoj se kjo duhet të lidhet me rregulloren tjetër dhe kjo të harmonizohet mirë, të jetë funksionale dhe e realizueshme. Ne e dimë edhe ndërtimet pa leje janë të ndaluara, por inspektorë nuk ka dhe nuk ndalohen këto ndërtime dhe kështu do të ndodh edhe me këtë rregullore dhe neni 6 i kësaj rregulloreje do të jetë i pazbatueshëm.

Isa Agushi- pajtohem me projekt-propozimin e kësaj rregulloreje dhe në parim e përkrahi, por propozoj të bëhen disa korrigjime. Te neni 4 (citohet), ky nen nuk ka kuptim, sepse ne i kemi inspektorët që duhet ta kontrollojnë këtë dukuri devijante dhe jo prindërit, sepse prindi nuk mund të qëndrojë në kafiteri me fëmijën. Unë mendoj se kjo duhet të ndryshojë dhe të thuhet se : “ shitësi, pronari nuk ka të drejtë të miturit t' i shërbejë me alkool, por edhe shitësi i duhanit të miturve nuk mund t' i shes cigare” Kjo është normë ndërkombëtare, kurse ku thuhet “ në prani të prindërit” nuk ekziston askund në botë.

Nxënësit dhe fëmijët, kanë të drejtë të hynë në lokal, por duhet shtuar nuk ka të drejtë shërbyesi t' i shërbejë me pije alkoolike dhe cigare.

Arben Maliqi- kjo rregullore është jashtëzakonisht e mirë dhe po m' i përkujton ato planet urbanistike të cilat po i bën DUMM të cilat plane në kin-projektor po duken me lisa dhe gjelbërim, por kurrë nuk kanë zbatim të tillë konkretë. Së pari vetëdija e qyfterëve nuk është në nivel për të pasur mundësi zbatimi i kësaj rregulloreje. Unë i frikohem vetëm zbatimit të kësaj rregulloreje, kurse në letër është e përkryer. Nuk e kemi në atë nivel, sepse na mungojnë shumë gjëra. Në shkollë nuk kemi pedagog, psikolog, por unë jam për ta aprovuar.

Hevzi Matoshi- nga vetë fakti se kemi një shqetësim të madhe për dukuritë negative nga ana e të miturve, kjo rregullore shton edhe obligime për subjektet shërbyese afariste. Në vijim z. Matoshi e citon nenin 3 të kësaj rregulloreje i cili normim nuk ka qenë si obligim deri më tani as me ligj as me ndonjë rregullore të veçantë.

Çështje tjetër është ajo se sa do të zbatohet në praktikë kjo rregullore, sepse ajo është faza tjetër e angazhimit të punës. Edhe unë jam për atë që mekanizmat ekzekutues të veprojnë, prandaj kërkoj që të aprovohet nga ana e anëtarëve të Kuvendit kjo rregullore.

Zijadin Maliqi- u tha se kjo rregullore është vështirë të zbatohet se gjëja nuk ka inspektorë, por inspektorët janë pranë drejtorive përkatëse, kurse ne si Kuvend duhet të kërkojmë zbatim të kësaj rregulloreje.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet pika 6 e rendit të punës?

Aprovohet pika 6 e rendit të punës: Projekt Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit me vërejtjet të cila u dhënë, kurse të tjerët abstenuan nga votimi .

7. Propozim vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor

Zijadin Maliqi- ky komitet është obligim statutar dhe ligjor, kurse kjo do të bëhet me konkurs publik, konkurrojnë kandidatët, kurse anëtarët e komisionit do t' i intervistojnë dhe i propozojnë kandidatët për këtë komitet.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me pikën 7 të rendit të punës, kurse kryesuesi kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet pika 7 e rendit të punës: Propozim vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan nga votimi.

Pas kësaj pike të rendit të punës, kryesuesi në ora 12.15 i liron në pushim anëtarët e Kuvendit deri në ora 13.15 min.

Pas këtij pushimi seanca i fillon punimet në ora 13.30 min sipas rendit të punës të paraparë në material të seancës.

2. Raporti financiar janar-mars 2015

Ilmi Limani – raportin financiar për janar-mars 2015 e sqaroi, drejtori i Financave, z. Ilmi Limani të cilin raport anëtarët e Kuvendit e kanë në material me shkrim.

Riad Rashiti- vlerësimi i GKK të PDK-së për raportin financiar tremujor janar-mars 2015.

Në analizën tonë të këtij raporti financiar, ne jemi fokusuar në tri shtylla kryesore

- Nivelin e realizimit të të hyrave vetanake, sipas planifikimit buxhetor

- Nivelin dhe formën e shpenzimit të buxhetit komunal gjatë këtij tre mujori
- Nivelin e investimeve në projekte kapitale, duke e krahasuar me periudhat paraprahe

Dhe sipas të gjeturave tona në këtë raport, ne kemi konstatuar se ky raport në përmbajtjen e saj shpreh:

- Mos efikasitetin e punës së qeverisjes komunale .
 - Tregon paaftësinë e institucioneve komunale për ta realizuar planifikimin e buxhetit për këtë vit kalendarik.
 - Të dhënat financiare sipas këtij raporti, thonë që shumica e sektorëve në Komunë, kanë dështuar plotësisht në inkasimin e të hyrave vetanake dhe vazhdon rënia e trendit të mos inkasimit
 - Po ashtu në bazë të raporteve nga sektorët tjerë të Komunës, shihet se shpenzimi i parasë publike vazhdon të bëhet duke shkelur ligjet dhe procedurat e prokurimit.
- Në përgjithësi, në këtë tre mujor kemi konstatuar se qeverisja komunale ka shkaktuar:
- Zvogëlim të buxhetit Komunal, si nga të hyrat vetanake, ashtu edhe nga grandet e qeverisë dhe të donatorëve
 - Keq menaxhimi në shpenzim të buxhetit dhe parasë së qytetarëve të Gjilanit
 - Rënie drastike të investimeve në projekte kapitale dhe mos mirëmbajtje të investimeve në përgjithësi

Për të vërtetuar këto konstatime tona si GKK të PDK-së, ne do t'i shpalosim me faktet dhe argumente, gjithëherë duke u mbështetur në të gjeturat e raporteve zyrtare të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, por edhe në raportet nga sektorët tjerë të Komunës së Gjilanit...

Duke filluar nga të hyrat vetanake, ku kemi rënie drastike në disa sektorë...

- Të hyrat e planifikuara nga biznesi në buxhetin komunal për vitin 2015 janë 150 mijë euro, -
- ndërsa për këtë tre mujor janë inkasuar vetëm 6.09% apo vetëm 9,139 euro. Ndërsa shumat e inkasuar në të njëjtën periudhë të vitit 2013, ka qenë 51,163 euro. Pra ka rënie drastike prej 600% krahasuar me kohën e qeverisjes së PDK-së.
- Të hyrat nga lejet e ndërtimi po ashtu kanë shënuar rënie drastike në krahasim me vitin e kaluar për 85%, nga 158 mijë euro në 85 mijë euro.
- Të hyrat nga Inspeksioni po ashtu kanë shënuar rënie të madhe prej 122% në krahasim me vitin e kaluar, nga 6682 euro në 3 mijë euro. Apo ka rënia për 172 % në krahasim me vitin 2013 kur qeveriste PDK dhe kur kishte kontroll në sektorin e ndërtimeve në Gjilan, e që tani është totalisht jashtë kontrollit fusha e ndërtimeve pa leje që e ka vërshuar Gjilanin, si pasojë e keqe qeverisjes dhe shuarjes së drejtorisë së Inspeksionit.
- Të hyrat nga tatimi në prone po ashtu kanë shënuar rënie, në krahasim me vitin e kaluar dhe planifikimin, në vlerë prej rreth 7%.
- Të hyrat nga Shëndetësia po ashtu kanë dështuar plotësisht, ku në bazë të planifikimit vjetor, është realizuar vetëm 10%, e që është dashur të jetë përafërsisht 25%....
- I Vetmi sukses dhe e arritur në të hyrat vetanake në buxhetin komunal për këtë 3 mujor, është rritja prej 100% e të hyrave nga Gjobat në trafik, ku nga 37 mijë euro sa kanë qenë në vitin e kaluar, janë rritur në 70 mijë euro.

Pra në total, sipas planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2015, do të duhej të inkasoheshin nga të hyrat vetanake, shuma e përafërt prej 965 mijë euro, ndërsa është realizuar vetëm 652 mijë euro, pra për 300 mijë euro ka dështuar realizimi i të hyrave nga komuna e Gjilanit për këtë tre mujor. Edhe në krahasim me vitin e kaluar, ka rënie prej 73 mijë euro....

Shpenzimet sipas këtij tre mujori

Niveli i shpenzimeve në total vazhdon të jetë i njëjtë sikurse në vitet e kaluara, dhe në këtë tremujor ka një rënie prej rreth 23 mijë euro. Nga 4,528,875.00 në 4,506,013.00 euro.

Edhe pse ka ndryshime pozitive në disa kode ku ka zvogëlim të shpenzimeve, por ka edhe ndryshime negative në disa kode, sidomos te shpenzimet për investime kapitale që kanë shënuar rënie prej 100% në krahasim me vitin e kaluar, ku kanë qenë 577 mijë euro në tre mujorin e vitit të kaluar, ndërsa në këtë vit ka vetëm 287 mijë euro.

Sigurisht që kjo ka të bëjë edhe më dështimet në realizimin e të hyrave vetanake, sepse kur nuk ka të hyra, nuk ka as shpenzime e investime kapitale... Por më e keqja komuna e Gjilanit tani nuk po mund as ti mirëmbajë projektet e investuara në të kaluarën... infrastrukturën, rrugët, ambientin dhe shumë sektorë të tjerë.

Të disa kategori të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, edhe pse disa here se ka zvogëlim të tyre, në realitet ato vazhdojnë të jenë të mëdha, sidomos te shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit, ku janë shpenzuar për këtë tre mujor 11,492 euro.

Vetëm vizitat e shpeshta të kryetarit të komunës jashtë vendit, i kanë kushtuar buxhetit të komunës hiq më pak se 5,988 euro, edhe atë vetëm për meditje jashtëvëndit 2,957 euro, krejt këto mijëra euro janë shpenzuar vetëm për tre muaj, janar-mars 2015.

Shërbime kontraktuese tjera (kontratë në vepër, shërbimet e varrimit, bartja e veturave, shoqata e zjarfikseve, mirëmbajtja dimrore etj.)

Ka zvogëlim prej 125,532.53 në 3 mujorin e parë të vitit 2014, ndërsa tani janë paguar 45,963.08 për tre mujorin e vitit 2015

- Shpenzimet për blerjen e mobileve ende vazhdojnë të jenë të mëdha, për vetëm këta tre muaj janë shpenzuar 11,473 euro
- Furnizime për zyre prapë shpenzime të tjera në vlerë prej 52,489 euro...

Për shpenzime të drekave zyrtare janë shpenzuar 7,437 euro si dhe për furnizim ushqim dhe pije 18,486 euro, në total 25,923 euro për tre muaj... apo mesatarisht për një ditë pune rreth 400 euro për ushqim, pije dhe dreka zyrtare. Do të thotë që ka zvogëlime të shpenzimeve por prapëseprapë janë të mëdha, kur kihet parasysh që për çdo ditë është thënë se ka dietë të ashpër buxhetore.

Shkelje ligjore dhe procedural të bëra nga komuna e Gjilanit, gjatë shpenzimit të parasë publike dhe të qytetarëve të Gjilanit, të cilat janë konstatuar nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, OSHP, AKK, KDI etj, të bazuara

Krenare Latifi- lidhur me raportin financiar të paraqitur në këtë seancë unë e kam vërejtur se në aspektin teknik është mirë i përgatitur, por në aspektin përmbajtjesor kam vërejtur disa mangësi të cilat po i numëroj sipas radhës: sa i përket mos inkasimit qëndrojnë të gjitha ato që i tha Riadi, sepse në të gjitha sektorët nuk janë inkasuar as përafërsisht mjetet të cilat kanë qenë të planifikuara? Mos inkasimi i mjeteve nga lejet e ndërtimit me planifikim janë paraparë 680 mijë €, kurse në këtë tre mujor janë realizuar vetëm 85 mijë €, kurse vitin e kaluar janë inkasuar mbi 158 mijë € e që është një diferencë mjaft e madhe. Po ashtu inkasimi nga bizneset e planifikuara janë paraparë 150 mijë €, ndërsa realizimin e kemi më pak se në tre mujorin e vitit të kaluar për 13 mijë e 615 €.

Po ashtu edhe te shërbimet publike të planifikuara janë 100 mijë €, kurse janë realizuar në këtë tre mujor 3 mijë e 900 € më pak se në tre mujorin e vitit të kaluar. Po ashtu edhe të hyrat nga Inspeksioni i kemi të planifikuara 450 mijë €, kurse të realizuara për tre mujor i kemi vetëm 3 mijë e 10 €.

Gjithashtu kërkoj edhe një sqarim për shpenzime të udhëtimit jashtë vendit për të cilën arsyeje janë shpenzuar 2 mijë 556 € te kodi 13140, po ashtu edhe mëditjet për udhëzim jashtë vendit te kodi 13141 në shumë prej 2 mijë e 975 €. Këto pagesa janë të qeverisjes së shkuar, apo të kësaj qeverisje, sepse ky është një shpenzim mjaft i madh dhe duhet të dihet se çfarë të mira i sollën qyteti tonë këto vizita jashtë vendit? Si është e mundur kur jemi në dietë buxhetore të bëhen vizita të tilla, ku kostoja e shpenzimeve është shumë e madhe, sepse kemi edhe shpenzime të udhëtimit janë mbi 2 mijë e 200 €, kurse për mëditje janë paguar 1 mijë 350 €.

Në fund i kam edhe dy rekomandime ose pyetje: me qëllim të zbatimit të transparencës, raporti financiar për vitin 2014 për periudhën janar-mars 2015 të publikohet në ueb faqe të Komunës.

Mirëpo me këtë raport financiar duhet të njoftohen edhe qytetarët përmes tubimeve në bashkësi lokale, në vendet urbane dhe ato rurale, sepse me këtë rast qytetarët do të njoftohen për inkasimin e mjeteve, mandej mënyrën e shpenzimit, por edhe investimet të cilat kanë ndodh në Komunë gjatë vitit 2014 dhe gjatë tre mujorit të këtij viti.

Nevzad Isufi- unë do të ndalem te dy segmente në të cilat kemi vërë theksin e një mungese të punës dhe është fjala për Drejtorinë e Inspeksionit, sepse në këtë kategori figurojnë shpenzime vetëm për pagë dhe nuk ka as për mallra dhe shërbime, por nuk ka as shpenzime komunale. Nga ko shihet se në këtë drejtori nuk është punuar fare, sepse nuk ka as shpenzime për letër.

Kam vërejtje edhe te emërtimi sepse nuk mund të thuhet vetëm, për kulturë, rini dhe sport, por duhet ditur se a kemi njësi, këtu apo kemi drejtori, prandaj kjo duhet të emërtohet. Jemi pajtuar që kjo të quhet njësi, pranë Zyrës së Kryetarit dhe kështu duhet të figurojë.

Një e dhënë inkurajuese për mua është se subvencionet në këtë fushë, por nëse ka mundësi të na sqarohet se cilat fusha janë subvencionuar, sepse shuma prej mbi 47 mijë €, është mjaft solide, por le të dihet se cili sektor nga kultura, sporti dhe rina është subvencionuar? Ne vazhdimisht kemi kërkuar që në sport të ketë më shumë subvencione dhe nëse kjo është bërë, atëherë jemi të kënaqur me këtë subvencionim.

Selami Xhemajli- sa i përket raportit për periudhën janar –mars 2015, grupi anëtarëve të AAK-së konsiderojmë se është një raport teknikisht dhe profesionalisht i përgatitur mirë me të dhëna të sakta për çdo sektorë dhe çdo drejtori. Mirëpo si vërejtje e cila është thënë edhe më parë është se raporti është mirë të përgatitet edhe me shkrim (fjalë dhe fjali), do të thotë të bëhet një lloj analize për raportin për sektorë të caktuar, sepse bartja e mjeteve nga viti i kaluar nuk është përmendur. Është e preferueshme që herëve të tjera krahas shifrave që janë mjaft të detajuara në formë tabelare, të bëhet edhe një përshtkrim i këtij raporti. Trendi i uljes së shpenzimeve vërehet çdo kund si te mallrat dhe shërbimet dhe çdo kod tjetër. Ne e përkrahim raportin me vërejtjet të cilat janë bërë edhe prej neve si grup, por edhe nga kolegët e tjerë.

Zijadin Maliqi- me rastin e analizës së një raporti duhet ta kemi parasysh edhe periudhën për të cilën paraqitet raporti financiar. Në këtë raport kemi të bëjmë me periudhën e parë tre mujore të vitit, në të cilën periudhë edhe të hyrat, por edhe shpenzimet janë shumë më të vogla se në periudhat e tjera kohore, sepse ndikojnë disa faktor në këtë aspekt. Janë disa punë të cilat nuk kryhen në këtë periudhë dhe këtë e dëshmoi edhe drejtori i cili theksoi se nga Inspeksioni më tepër janë realizuar mjete në muajin prill se sa në tre muajt e parë të vitit. Mandej varet edhe prej vitit, sepse ky vit ka qenë më i ashpër se sa vitin e kaluar. Sa i përket shpenzimeve edhe këto janë në nivelin e parashikimeve, por edhe tek shpenzimet ndikojnë të njëjtit faktorë.

Në këtë rast kemi të bëjmë me borxhet nga vitet paraprake të cilat kanë mbetur, por një problem tjetër është mosfunksionimi i fribalansit, sepse është bërë ndryshim në fribalans nga Qeveria e Kosovës dhe për këtë arsyeje janë paraqitur probleme.

Edhe unë po theksoj se nuk jemi të kënaqur me të hyrat, nëpër disa kategori të hyrave, prandaj kërkojmë nga disa drejtori që gjatë muajve të ardhshëm të angazhohen dhe nuk mund të themi se

kemi realizuar buxhetin 25%, sepse buxheti planifikohet për tërë vitin dhe në fund të vitit mund ta dimë sa është realizuar buxheti i një komune. Në fund po theksoj se ky raport financiar është me rëndësi, sepse paraqet një gjendje shumë reale dhe nuk mund të qitet diçka në raport që nuk ka kaluar përmes Ministrisë së Financave. Të gjitha të hyrat dhe të dalat janë paraqitur mirë edhe në mënyrë analitike dhe sintetike dhe raporti është shumë real.

Arben Maliqi- edhe unë si kolegët e tjerë jam i mendimit se ky raport është në nivel se Komuna e Gjilanit ka pasur fat, sepse gjithmonë drejtorët e financave i ka pasur shumë profesional duke filluar nga i ndjeri Nazmi Maliqi, Nuhi Nuhiu, por edhe z. Ilmi Limani po kryen punën me mjaft profesionalizëm. Mirëpo unë kam pyetje konkrete lidhur me borxhet dhe a është paguar ndonjë borxh gjatë kësaj periudhe janar-mars dhe sa është shuma?

Ilmi Limani- unë e sqarova se të hyra ka nga inspeksioni tregut dhe kur t' i mbledhim të gjitha del se janë realizuar të hyra më tepër se vitin e kaluar. E dyta të hyrat e biznesit vitin e kaluar nuk kanë qenë 51 mijë €, por kanë qenë mbi 22 mijë €, kurse sivjet janë mbi 9 mijë e 900 €. Mirëpo me trendin që ka filluar në muajin mars dhe prill është një lëvizje shumë e mirë.

Të hyrat e biznesit tonë, por janë të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, sepse aty ekziston një zyrtar shumë të mirë i cili e bën ngarkimin e taksave. Sa i përket tatimit në pronë unë jam shumë i kënaqur, sepse kemi arrit në 96% të inkasojmë mjete nga tatimi në pronë.

Shpenzimet jashtë vendit janë bërë nga Zyra e Kryetarit, sepse disa delegacione kanë udhëtuar jashtë vendit, por edhe shpenzimet e anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë qenë në Turqi. Shpenzimet për pije dhe ushqim janë për çerdhe të fëmijëve dhe Konvikt të Nxënësve dhe Studentëve.

Riad Rashiti- sa i përket inspeksionit unë jam munduar t' i bëj disa krahasime me periudhat paraprake. Unë nuk e thash se vitin e kaluar kanë qenë 51 mijë €, por kanë qenë për vitin 2013, kurse tash janë 9 mijë 999. sa i përket inspeksionit është që drejtori mos t' i paraqes të dhënat ku është përqindja e madhe, por duhet dhënë faktet në total. Në përgjithësi realizimi i të hyrave në vitin 2014 për të njëjtën periudhë ka qenë mbi 725 mijë €, kurse këtë vit është mbi 652 mijë €, do të thotë ka rënie për 73 mijë €. Mirëpo nëse e krahasojmë me planifikimin ka rënie 300 mijë € më pak realizim. Në fund po e bëj një pyetje se ka ndonjë inspektor të ndërtimit Komuna e Gjilanit dhe nëse ka tegoni, por nuk ka inspektor të ndërtimit në sezonën e ndërtimit dhe për këtë arsyeje nuk mund të rriten të hyra, sepse nuk ka kontroll absolut.

Ilmi Limani- i mbeta borxh anëtarit të Kuvendit Nevzad Isufi. Planifikimi i buxhetit bëhet në shtator, kurse Statuti është ndërruar më vonë, prandaj pagat e inspektorëve paguhen nga Drejtoria e Inspeksionit, kurse shpenzimet bëhen nga drejtoritë përkatëse.

Zijadin Maliqi- ky është raport financiar dhe shpenzimet krijohen nëpër drejtori përkatëse, kurse drejtori raporton. Unë e thash se nuk jemi edhe shumë të kënaqur me këto të hyra, por nuk mund të themi se është edhe keq, prandaj kërkojmë nga drejtoritë përkatëse që në të ardhmen të punohet dhe angazhohen edhe më tepër?

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi kërkon që të aprovohet pika 2 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2 e rendit të punës: Raporti financiar janar-mars 2015, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, 5 ishin kundër, kurse të tjerat ishin abstenime.

3. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronë e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike “Deponia e Mbeturinave”-Velekincë

Zijadin Maliqi- unë propozoj që edhe pika e 4 e rendit të punës të shqyrtohen në këtë pikë, sepse pika 3 dhe 4 kanë të njëjtën çështje.

Kuvendi u pajtua dhe u mor vendim që pika 3 dhe 4 e rendit të punës të debatohen me një pikë.

Sadudin Berisha- më vjen mirë që morët vendim që dy propozim- vendimet të debatohen në pako, sepse edhe ashtu janë debatuar në dy komitete. Propozimet dhe vendimet i keni brenda materialit me të gjitha të dhënat të cilat duhet t' i përmbajë një rast i tillë. Një vendim ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të vitit 2009, por për mungesë të të dhënave është deshtë që ta ripërsërisim dhe të vërtetohet se është marrë vendim në KK. Për çdo interesim dhe pyetje që keni unë mund t' iu informoj.

Nevzad Isufi- unë e kam një pyetje për vendimin e dytë: a ka mundësi të caktohet saktësisht ku është kjo pronë, sepse unë jam përpjekur për ta gjetur në bazë të numrit të parcelës në atë programin, por nuk kam mundur ta identifikoj saktë ku është sipërfaqja e ndërrimit prej 5 ari?

Sadudin Berisha-nëse nuk e gaboju është diku pranë Shkollës Filllore "Selami Hallaçi".

Riad Rashiti- sa i përket pikës së 3 të rendit të punës unë e kam një pyetje: së pari unë përkrahi këtë propozim që të bëhet zgjidhja e kësaj prone, mirëpo kam pyetje për drejtorin e Kadastrit se a kërkohet me ligj që së pari të bëhet shpallja e interesit publik për çështje të rrugës, pastaj të zhvillohen procedurat? Nëse po a është shpall interesi publik në Komunë të Gjilanit ?
Sa i përket pikës 4 ne e përkrahim këtë propozim që të epet në shfrytëzim hapësira publike Komunës për nevoja të xhamisë, sepse kemi të bëjmë me një komunitet i cili ka nevojë për hapësirë.

Sadudin Berisha- KK e ka shpallur atë zonë me interes publik, është përcaktuar edhe emërtimi dhe ka përfunduar.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesi z. Maliqi kërkon që të aprovohet pika 3 dhe 4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 3 dhe 4 e rendit të punës: 3 Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronë e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike "Deponia e Mbeturinave"-Velekincë dhe 4 - Propozim vendimi për lejimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës për nevojat e Xhamisë në Lagjen "Zabeli i Sahit Agës", me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

8. Propozim- Plani i punës së KKS-së për vitin 2015-05-06

Halit Rexhepi – planin e punës e elaboroi drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, por ky plan iu është dorëzuar anëtarëve të Kuvendit edhe me shkrim.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë, kurse kryesuesi kërkon që të aprovohet pika 8 e rendit të punës?

Aprovohet pika tetë (8) e rendit të punës: Propozim- Plani i punës së KKS-së për vitin 2015-05-06, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë (31) .

Të ndryshme

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – së pari në këtë pikë do t' i theksoj unë disa vërejtje të cilat vazhdimisht po na vijnë nga opozita.

- vazhdimisht është thënë se shumë vendime të KK-së janë anuluar nga MPL-ja, por kjo nuk qëndron, sepse deri më tash na është anuluar vetëm një vendim: Vendimi për shfrytëzim të pronës

për familjen e Fatmir Jusufit. Ka qenë vullnet i mirë i të gjithëve që t'epet në shfrytëzim toka e Komunës këtij person i cili është skamnor, por MPL e ka kthyer për të dytën herë si vendimi i paligjshëm. Kërkoj mirëkuptim nga ju anëtarë të Kuvendit që të votoni dhe anuloni këtë vendim?

Anulohet vendim për dhënie në shfrytëzim të pronës së Komunës, z. Fatmir Jusufit me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- nën të ndryshme nga Bujar Nevzadi është kërkuar që të epet informatë për Ndërtimet pa leje, mandej çështja e Shtëpisë së Kulturës në Përlepnice si dhe çështja e Pendës po në këtë fshat, por u tha diçka për tenderin për servisim të automjeteve.

Sa i përket tenderit për servisim të automjeteve, unë e posedoj një kompani për qëllime të tilla e cila quhet "Universal". Firma "Universal" ka qenë konkurruese në këtë tender, por "Universal" ka qenë kompania më e shtrenjtë, kurse tenderi iu ka dhënë kompanisë e cila ka qenë më e lira dhe nuk ka nevojë për spekulime.

Sokol Haziri- unë sot i kam marrë tri pyetje nga anëtarët e Kuvendit dhe e para ka të bëjë me gropat të cilat janë krijuar në rrugë të qytetit. Kërkesën për mirëmbajtje të rrugëve e kam dërguar në

Departamentin e Prokurimit me 2 mars 2014, por po zhagiten procedurat e prokurimit dhe për pa përfunduar këto procedura, unë nuk jam në gjendje për të ndërmarrë diçka.

Mandej pyetje tjetër pse disa gropa janë mbyllur me kubëza, mirëpo një mbyllje e tillë e gropave është bërë gjatë zezonës së dimrit, sepse asfalti në këtë kohë është i paqëndrueshëm dhe porsa të fillojmë me mbylljen e gropave të tjera, ato kubëza do të hiqen dhe do të shtrohen me asfalt.

Sa i përket Sheshit "Xhavit Ahmeti" jam në dakord me juve se plotësisht është degraduar ai shesh, sepse kafiteritë afër këtij sheshi i kanë kaluar të gjitha kompetencat. Mirëpo ne së bashku me Inspeksionin do të fillojmë për ta kthyer atë shesh në gjendje normale.

Sa i përket pyetjes së tretë e cila ka të bëjë me parkingun në lagjen "Dardania" është shumë e vërtetë që aty ka kaos të parkingut, por te rasti konkret nuk kemi parking të sinjalizuar, por në biseda me qytetarë në atë pjesë na është sugjeruar që mundësisht të bëhet një vijë në njërën anë të rrugës nëse lejojnë kushtet teknike?

Valentinë Bunjaku -Rexhepi- z. Riad Rashtin ka bërë pyetje përkitazi me fondin humanitar ose Gala Mbrëmja, por kësaj pyetje do t' i përgjigjem me shkrim, sepse nuk i posedoj të dhënat këtu.

Sa i përket dëmeve nga vërshimet, është i autorizuar zv/kryetari i Komunës i cili me merret me këtë problematikë, por edhe për këtë rasat, unë do të përgjigjem me shkrim.

Fehmi Sylejmani- një pyetje shtesë sa i përket Sheshit Xhavit Ahmeti, sepse në atë shesh janë vendosur këto ditë dy kiosqe, kush ka dhënë leje dhe në bazë të çfarë kriterëve urbanistike janë vendosur ato kioske aty? Pyetja tjetër është për drejtorin e Financave është se në raportin financiar në pjesën ku trajtohet puna e Zyrës së Personelit qëndron e dhëna se në vitin 2014 ajo zyrë i ka hartuar 220 kontrata në vepër, por edhe Drejtoria e Arsimit gjatë këtij viti i ka punësuar mbi 50 punëtorë me kontratë në vepër. Pyetja e ime për drejtorin e Financave është pagesat e tilla a janë në pajtim me dispozita ligjore? Po ashtu një pyetje për shefin e Zyrës Ligjore, këto kontrata në vepër të cilat i theksova këto kontrata në vepër a janë në pajtim me Ligjin për shërbyesit civil dhe me këtë rast a ka keqpërdorim të detyrave zyrtare?

Sokol Haziri-është e vërtetë se një kiosk është vendosur në Sheshin "Xhavit Ahmeti" në këndin e saj dhe tjetra në brendi të zonës së shkollës, por që të dy këto kioske janë me vendime të përkohshme dhe në kohën kur fillojnë punimet aty ato kioske do të hiqen. Ne për shkak të gjendjes së rëndë sociale të qytetarëve i kemi bërë disa lëshime, por të gjitha këto janë me vendime të përkohshme derisa prona publike nuk shpallet në ankand publik.

Ilmi Limani – sa i preket kontratave në vepër janë disa kontrata për shërbime. I kemi disa donatorë nga BE dhe OJQ të ndryshme, por ata njerëz nuk mund të futen në lista të pagave, por lidhin kontrata për shërbime. Kontrata për shërbime mund të bëjmë, kurse afatgjata jo !

Halit Rexhepi – z. Renan Imam ka bërë pyetje për ndërrimin e anëtarit të KKSBB-së. Kjo çështje është debatuar në KPF, por kjo çështje është shtyrë, sepse duhet t' i respektojmë procedurat, sipas Udhëzimit administrative për këtë çështje.

Renan Imam- faleminderit z. drejtor, ne do ta bëjmë kërkesën sipas ligjit dhe procedurave që duhet ndjekur.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- ka qenë një pyetje përkitazi me debatin publik për rregullore të ndryshme, por ne nuk jemi të obliguar për të dhënë të dhëna të tilla. Debati është mbajtur me aq sa ka pasur qytetarë dhe ka mundur të vijë çdo njeri që dëshiron.

Sa i përket gërvishtjeve të nxënësve të cilën pyetje e bëri Fatbardhë Selmani, për këtë arsyeje është shpejtuar kontrolli sistematike dhe është arrit për ta ndaluar këtu dukuri, por edhe kemi shumë pak fëmijë të prekur për të cilat raste policia i ka të dhënat e sakta.

Avdyl Aliu- z. Aliu para anëtarëve të Kuvendit foli për disa shpifje të cilat po i bëhen vazhdimisht nga kolegët e tij në Kuvend, ndaj personaliteti të tij dhe ndaj ndërmarrjes të cilën e posedon. Shumë shpesh jam akuzuar për ndërtime pa leje, por unë i kam këtu tri leje ndërtimore. Mirëpo z. Aliu para anëtarëve të Kuvendit e shpalosi tërë dokumentacion dhe dëshmoi se si ndërtues në KK të Gjilanit nuk ka pasur ndërtime pa leje. Mirëpo dy objektet e fundit kanë tejkalim, sepse ka pasur nën kulm dhe është bërë kat, por fatmirësisht tash është ligji për legalizim e të cilën procedurë do ta zbatojë sipas ligjit.

Vazhdimisht akuzohem për materialin ndërtimor që është shpërndarë gjatë kohës që ka ndodhur tërmeti në Gjilan. Disa koleg nuk kanë lënë gur për pa lëvizur për këtë çështje dhe hetimet kanë zgjatur deri në vitin 2007 duke filluar nga viti 2003. Gjatë tërë kësaj periudhe nuk është gjetur asnjë keqpërdorim dhe kjo akuzë është hedhur poshtë nga Prokurori Speciale e Kosovës.

Në vijim të fjalës së tij z. Aliu para anëtarëve të Kuvendit e shpalosi dokumentin e lëshuar nga gjykata Themelore në Gjilan se ndaj tij nuk është bërë aktakuzë e plotfuqishme dhe nuk është dënuar asnjëherë me gjykim të formës së prerë.

Jam akuzuar se unë jam uzurpator, por edhe për këtë rast z. Aliu e shpalosi dokumentin e lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit se Avdyl Aliu nuk evidentohet si uzurpator dhe nuk gjendet në listën e uzurpatorëve.

Akuzë tjetër që më bëhet është se gjëja unë në Zabel e kam penguar projektin e kanalizimit në këtë lagjeje, por edhe për këtë akuzë z. Aliu dëshmoi dokumentin nga Departamenti i Prokurimit se nuk ka bërë asnjë pengesë për kalim të kanalizimit nëpër prona të Avdyl Aliut. Për këtë rast z. Aliu pati dokument edhe nga Shërbimet Publike dhe organeve të tjera përgjegjëse. Këto dhe disa të tjera janë disa çështje për të cilën po akuzohem, por unë e dëshmoja dhe çdo herë mund ta dëshmojë se në asnjë rast nuk ka punuar në kundërshtime me ligjin, por të gjitha këto janë shpifje dhe akuza të pabaza.

Riad Rashiti- mua më vjen mirë që kolegu i paraqiti argumentet e tij dhe parimisht e përkrahi, sepse është e rëndë kur dikush të akuzon për diçka që nuk ka ndodhur. Unë e inkuraroj z. Avdylin që edhe të vazhdojë dhe bëjë padi për të gjitha shpifjet që iu kanë bërë. Mirëpo ne gjithmonë jemi munduar që mos ta personalizojmë asnjë debat, por tendenca e disa kolegëve që çdo herë që kemi ngrit ndonjë parregullsi jemi sulmuar për çështje personale.

Është mirë që ta pranojmë realitetin qoftë për bizneset tona private, qoftë ato politike, por edhe angazhimet të cilat i bëjmë në KK. Ne po duam të jetë ashtu si po thotë z. Aliu, por nuk është bash ashtu, sepse ne i kemi komisionet tona dhe është konstatuar se ka pasur dalje në hapësirat publike.

Te lejet ndërtimore është e vërtetë, sepse në qeverisjen tonë asnjë ndërtim nuk ka pasur mundësi të bëhet pa leje. Komuna ka lëshuar leje te ish Fabrika “Kualiteti” e cila ka falimentuar dhe aty është bërë zonë e ndërtimeve dhe ne dimë që ka leje, por e dimë që ka edhe shkelje.

Mirëpo ka bërë shkelje një kompani publike e cila lëshon vërtetim që nuk ka obligime, për pa i kryer obligimet pronari i tokës! Janë 5- 6 mijë euro obligime të pa kryera dhe investitori e merr lejen për ndërtim dhe kjo ka ndodhur sot.

Sa i përket dokumenteve të lëshuara nga organet e drejtësisë, unë po deklarohej në Kuvend se mbi 90% e kemi mosbesimin për punën e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ne dimë se si ka funksionuar sistemi i drejtësisë në Kosovë pas luftës dhe e dimë se çka ka ndodhur me pronat publike. E dimë se si Eulexi doli më i korruptuari në Kosovë i cili ka pasur ndikim në drejtësi.

U dëshmuar se Prokuroria Themelore në Gjilan para pak jave i mbylli 4 raste të tenderëve të cilat ne i kemi dërguar për t’ i hetuar. Kryetari i Komunës nuk është këtu, sepse ai nuk është në gjendje të ballafaqohet, por një pyetje ia kisha bërë? Pse i mbylli Prokuroria Themelore në Gjilan këto raste?

I mbylli, sepse ka ndikuar kryetari i Komunës, ka shpërblyer persona të caktuar dhe janë mbyllur rastet. Ne e dimë se si punon drejtësia në Kosovë dhe eluxi etj?

Sa i përket materialit ndërtimor për rastin e tërmetit ne vazhdimisht e kemi kritikuar qeverisjen komunale, sepse nga Qeveria e Kosovës është ndarë fond 2.5 milion euro për t’ i kompensuar dëmet nga tërmeti. Qytetarëve iu janë dhënë 1.5 milion, kurse 1 milion €, janë investuar në infrastrukturë në kohë të zgjedhjeve lokale. Në vijim z. Rashiti i përmendi edhe disa keqpërdoremi dhe theksoi se sot po blihet gjithçka, prandaj blihet edhe drejtësia.

Nevzad Isufi- në pyetjen time u përgjigjet vetëm pjesërisht, prandaj pjesa e dytë e pyetjes është se sa propozime të qytetarëve janë marrë parasysh dhe cilat prej tyre janë miratuar? Në procesverbal duhet të ishin këto të dhëna.

Pyetja tjetër është pse nuk ka rregullore për ndarje të bursave, prandaj kërkoj përgjigje me shkrim pse nuk ka dhe kur do të hartohet?

Nuk është raportuar për anëtarët e Kuvendit për vizitën në Turqi dhe nuk dihet se cilat janë rezultatet e kësaj vizite dhe të na epet përgjigje me shkrim? Mandej të bëhet auditimi i të gjitha kontratave për vitin 2014?

Pyetja e fundit pse Plani i departamentit të Prokurimit pse nuk është paraqitur në KPF?

Bujar Nevzadi- z. Avdyl Aliu doli në foltore për t’ u rrëfyer dhe për ta larë veten, por unë po i them që po të ishte i larë nuk do të ishte marrë aq gjatë nëpër gojë, sepse në Kuvend ka edhe të tjerë anëtarë (35), por të tjerët nuk po merren nëpër gojë. Unë po të them to gjykata mos i ndal, por po ta përmendi tërmetin me pak fjalë. Një xhaxha i imi i cili është i ndjerë i ka marrë 2 mijë €, por e ka shit armaturën me 500 €. Do të thotë 1mijë 500 €, i ka shpenzuar për qëllime të tjera. Këtu ka keqpërdorime. Në qeverisjen tonë i kemi ndarë disa mjete për dëmet nga breshëri, por a keni dëgjuar ndonjë fjalë? Nuk është ankuar as një njeri, prandaj nuk ka lumë që të lanë z. Aliu!

Këto letra për tejkalime t’ i ka dhënë ky drejtori i tashëm i cili ka qenë në Komision për keqpërdorime, por ka ardhur një pushtet tjetër dhe e ka bërë drejtor. Vetë e thatë se një kat e keni ndërtuar më shumë se e keni pasur leje, çka do të thotë kjo?

Është e sigurt se e ke penguar kanalizimin e 50 familjeve dhe këtë ta kam thënë shumë herë.

Avdyl Aliu- në një pyetje po përgjigjem. Z. Bujari po e përmend keqpërdorimin e materialit nga dëmet e tërmetit, sepse xhaxhai i tij i ka marrë 2 mijë euro, material dhe e ka shit 500 euro.

Mirëpo “Agrohermes” e ka pasur me kontratë vetëm të shpërndaj materialin nëpër shtëpia dhe nuk e ka pasur për obligim t’ ia ruaj qytetarëve materialin.

Jetullah Kadriu- është fjala për një shkollë të Lagjeja “Pireva”, por janë disa persona, por njëri prej tyre Isa Xhelili e ka lejen e ndërtimit dhe tërë dokumentacionin dhe tash nuk i lejohet ndërtimi

, sepse gjëja se shkolla është e interesuar t' i merr ato troje. Është mirë që drejtori të shikojë mundësinë se si qëndron gjendja, sepse është jashtë murit, por nuk i lejohet ndërtimi këtij qytetari?

Nazmi Musa- unë do të përgjigjem në disa pyetje të cila m' u bënë dhe e para ishte ajo e Riad Rashitit për anulimin e konkursi për drejtor dhe zv/drejto. Mirëpo këto gabime janë bërë si shkak i kundërvënies së një ministrie me tjetrën, për arsye të ligjit për shpallje të vendeve të drejtorëve dhe zv/drejtorëve. Konkursi për drejtor dhe zv/drejtori duhet të shpallen sipas Ligjit për shërbimin civil, kurse Ministria e Arsimit thotë se këto vende duhet të shpallen sipas Ligjit parauniversitar, prandaj për këtë arsye është krijuar ky konflikt.

Ligji për maturën shtetërore dhe procedurat e tjera u përmend nga z. Arben Maliqi, por po e theksoj se Gjilani gjithmonë ka treguar rezultate në përgatitjen teknike për këtë çështje. Janë ligjet, por është në shqyrtim edhe Ligji i cili do të vendos se a do të kalojë ligji në bazë të testit të maturës në bazë të arriturave të përsëritshme, apo në bazë të arritshmrisë ashtu si është te semi maturantët?

Sa i përket pyetjes së Fatbardha Selmani për vetëlëndimin e nxënësve është rast i izoluar është rast i vetëm që ka ndodhur në “Selami Hallaç” dhe është rast që nuk ka nevojë të përflitet në opinion.

Sa i përket pyetjes për rritje të buxhetit nuk është në kompetencë të këtij Kuvendi.

Për pyetjen lidhur me mungesat në mbledhjen e ardhshme ose në ndonjë seancë të jashtëzakonshme do t' iu sjell të gjitha mungesat e mësimdhënësve, sepse ne jemi mësuar të merremi vetëm me mungesat e nxënësve dhe për 30 mungesa e përjashtojmë nxënësin nga shkolla. Mirëpo nga të dhënat që i posedojmë, është befasi me numrin e madh të mungesave të mësimdhënësve dhe shumica prej tyre janë të arsyeshme. Unë do të konsultohem me ligjin dhe të gjitha mungesat të arsyeshme apo të paarsyeshme do të kenë ndalesa, por do të lirohen vetëm mungesat të cilat janë për shkaqe shëndetësore dhe atë me vërtetim nga Komisioni mjekësor.

Pyetjes pse nuk ka rregullore për bursa, nuk e kam të qartë se a ka pasur rregullore më herët, por e di që ky Kuvend (mandati i kaluar) i ka hartuar kriteret për ndarje të bursave. Kurse për lagjen “Pireva” nuk kam njohuri, por kjo pyetje duhet t' i bëhet Drejtorisë së Kadastrit.

Bujar Nevzadi- këtë që po e thotë drejtori sa i përket mungesave me arsyeje ose pa arsyeje do t' i zbritet paga mësimdhënësve, mendoj se nuk është ligjore të zbritet mëditja për mungesa me arsyeje. Mësimdhënësit ka raste të sëmurje, vdekjes dhe raste të tjera dhe nuk është e arsyeshme t' i zbritet mëditja.

Riad Rashiti- unë e kam një pyetje më konkrete lidhur me përzgjedhjen e drejtorit në Shkollë të Mjekësisë. Në vendim ka shumë sqarime pse është anuluar përzgjedhja e drejtorit të Shkollës së Mjekësisë nga i cili vendim z. Rashiti e lexon një pasues. Nga ky pasues shihet se Komuna e Gjilanit nuk ka bashkëpunuar me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe Shërbimin Civil të Kosovës duke mos ofruar as dosjen e regrutimit dhe asnjë provë tjetër lidhur me procedurën përzgjedhjes së kandidatit. Pyetja është pse ju nuk keni kthyer përgjigje dhe nëse ka pasur konflikt në mes dy ligjeve, pse nuk keni dhënë përgjigje?

Arijetë Rexhepi- drejtorit të Arsimit ia kam drejtuar një kërkesë para dy muajve, nëse ka mundësi të jap tash përgjigje, por nëse jo atëherë të deklarohet kur është i gatshëm të jap përgjigje?

Fehmi Sylejmani- një pyetje shtesë për drejtorin e Arsimit. Unë së pari e përgëzoj për atë qëndrim që ka lidhur me mungesat, por mundësisht ato mungesa të shikohen, sepse zyrtarët që merren me çështjen e mungesave nëpër shkolla të jenë më racional. Nëse nuk veprohet kështu do të na dalin një numër i madh i mungesave, prandaj të jeni pak më racional.

Mirëpo e kam edhe një pyetje lidhur me Shkollën e Bujqësisë se gjëja kjo shkollë do të hyjë në bashkëpunim me PPP-në, prandaj kam pyetje se a keni dijeni dhe a ka gjasa që të ndodh kjo?

Arben Maliqi- ne vazhdimisht kemi thënë se Arsimi e ka një mal me probleme dhe është një ndër sektorët më të ndjeshëm, por i cili në Gjilan ka funksionuar mirë. Unë e di që nuk është

kompetencë e jona, por kam pyetje lidhur me Kampusin Universitar dhe të lus që ta merrni iniciativën, sepse ju jeni njeri i parë i arsimit në Komunë të Gjilanit. Në Gjilan ekzistojnë katër fakultete, hapësira është minimale dhe kushte nuk ka. Konkretisht e kam fjalën për Fakultetin e Kulturës Fizike i cili në mungesë të hapësirës, sipas të gjitha gjasave do të hapet në Pejë. Është mirë që ky fakultet mos të ik nga Gjilani, sepse kuadri ekziston dhe aktualisht janë nëntë doktor të shkencave sportive. Është mirë që ta merrni një iniciativë të tillë së bashku me kryetarin e Komunës.

Nazmi Musa- gjithçka që propozohet për arsim, është obligative që unë t' i marrë në shqyrtim për aq sa mund t' i zgjidh. Sa i përket kurseve, unë jam i pari në Kosovë dhe ju si Kuvend e keni aprovuar një rregullore. E kam biseduar këtë me drejtorët e shkollave, por edhe me drejtorët e drejtorive në Ministri. Në ministri është kualifikuar si vepër negative në kuadër të kësaj që mbahen kurset private me nxënës jashtë shkollave. Në ministri është thënë se do të nxirret një udhëzim i cili do të jetë shumë i qartë dhe shumë i prerë. Unë jam ndal tash dhe nuk kam marrë iniciativë tjetër, sepse jam në pritje të këtij Udhëzimi.

Anulimi i konkursit që e tha z. Riadi është edhe një e metë që u tha pak më parë se bashkëpunimin e kemi pasur shumë në nivel, por me këtë rast e kanë nxjerr vendimin që konkursi të shkojë në rishqyrtim. Ne e kemi rishpall konkursin dhe janë disa gjëra që ne i marrim dhe i përgjigjemi zyrtarisht, por ata nuk i kthejnë, prandaj ju mund të shkoni dhe pyetini atje.

Kërkesave tjera do t' i përgjigjem, pasi t' i marrë pyetjet në formë elektronike.

Mungesat mos të futen të gjitha në një thes, sepse ka mungesa edhe për çështje shumë të pa arsyeshme. Te Shkolla e Agrobiznesit, kam qenë dhe jam shumë aktiv, janë marrë edhe masat dhe askush prej juve nuk mund ta shpëtoni atë njeri (drejtorin). Askush nuk ka të drejtë ta shndërrojë atë shkollë në biznes të PPP-së, sepse nuk është shkollë që prodhon dhe shkollë që e ka fuqinë prodhuese si biznes, por është shkollë për mësim dhe për praktikë.

Sa i përket çështjes së Kompusit Universitar, unë nuk kam qasje në këtë institucion, sepse nuk jam as kryetar, as rektor i Universitetit.

Leonorë Bunjaku- unë kam nevojë edhe për disa sqarime shtesë. Sa i përket çështjes së mungesave me sa e kuptova unë qenka problemi të menaxherët e juaj dhe jo të mësimdhënësit ! Nëse mësimdhënësi kërkon leje pa arsyeje dhe drejtori e arsyeton, atëherë kjo të mbetet çështje e tij.

Mirëpo nuk duhet futur të gjithë në një thes ! Atëherë si duket unë ose kolegët e mi që nuk kemi dollovere me drejtorët dhe nuk pimë kafe me drejtorin, atëherë ku duhet të vijmë për t' i arsyetuar ato mungesa? Tjetra është se ne këtu jemi 7-8 mësimdhënës, ditën që e kalojmë në seancë si e arsyetojmë këtë ditë? Konkretisht si e arsyetoj sot unë këtë ditë të sotme? Mandej ka raste kur mësimdhënësi ka raste të ndryshme familjare dhe nuk duhet trajtuar të gjitha rastet e njëjta !

Ju lutem t' i keni në konsideratë këto gjëra, por edhe Zyra Ligjore mund të jep sqarime.

Mevludë Zehnullahu- unë e kam një sqarim se Shkolla Ekonomike më parë ka qenë donacion i Swis kontaktit, por tash ko organizatë është tërhequr që dy vite dhe ne për këto dy vite nuk kemi pasur mundësi t' i sigurojmë 200 € për të marrë pjesë në Panairin e gjërave ushqimore që organizohet, brenda territorit të Kosovës, por më parë jashtë Kosovës kemi marrë pjesë 5 vjet rresht. Vitin e kaluar për të marrë pjesë na i ka siguruar mjetet veta zv/kryetari. Sivjet për 200 € nuk kemi mundur të marrim pjesë për ta prezantuar shkollën me gjërat ushqimore në panairin që është mbajtur me 22 prill në Prishtinë.

Nazmi Musa- u bë një pyetje shtesë lidhur me mungesat dhe ajo ishte se si të arsyetohen mungesat e atyre që marrin pjesë në seancë të Kuvendit? Drejtori i shkollës për këto gjëra është, duhet t' i drejtoheni drejtorit, sepse unë nuk e di kush kur mungon? Unë e kam thënë pa arsyetime me shkrim dhe pa arsyetime nga ai që vetë mungon nuk ka se si të arsyetohen mungesat.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- anëtarët e Kuvendit që janë punëtorë të arsimit mungesat e tyre arsyetohen me ligj, sepse kjo është e rregulluar me ligje.

Bujar Nevzadi- unë sa kam qenë drejtor, ka pasur anëtarë të Kuvendit të përgjegjshëm, por edhe tash ka, por ka pasur edhe të papërgjegjshëm. Këtë po e them se shumë herë seancat i kemi përfunduar në ora 13, kurse anëtari i Kuvendit mësim ka pasur pas dite, por nuk ka shkuar në mësim. Nëse ka këso raste atij anëtari të Kuvendit duhet t' i zbritet mëditja. Është mirë që seancat të caktohen vetëm në një ditë të javës në mënyrë që punëtorët e arsimit atë ditë ta kenë të lirë.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- z. Sylejmani gjatë seancës më tha se unë të njoh ty ! Dua sqarim para Kuvendit se si më njeh z. Sylejmani mua? Në këtë Kuvend për një lapsus të një anëtari të Kuvendit e keni lëshuar sallën, prandaj si më njihni mua ju, kërkoj sqarim?

Fehmi Sylejmani – kjo nuk ishte asgjë për çështje private dhe mos i ngatërro dhe unë bëra pyetje për planin e punës.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi- për Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik kishte pyetje : është pyetje për aksionarët të cilët nuk kanë raportuar në Kuvend, mandej është fjala për Muhadin Hazirin se gjëja është kthyer në Eco- Higjienë. Gjithashtu lidhur me aksionarët Komunës së Gjilanit thuhet ka konflikt interesi

Riad Rashiti- unë kam një pyetje lidhur me një vendim që e ka marr KK për emërimin e anëtarit të Komisionit në Kompaninë “Eco-Higjiena”. Në momentin kur e ka votuar në vitin e kaluar KK, drejtori i Zhvillimit Ekonomik që të jetë një prej anëtarëve të Komisionit Komunal në këtë kompani, por unë atëherë e kam bërë pyetjen se a je duke e ditur dhe a e njihni statusin e atij personi të cilin ju e propozoni? Unë sot edhe njëherë po pyes të ngjashme për këtë problem. Secilit kandidatë që kërkon të hyjë në vend të punës i kërkohet një vërtetim nga Gjykata se ai person nuk është nën hetime, sepse nëse nuk e siguron atë vërtetim, ai person nuk ka të drejtë as të intervistohet nga komisioni për ta pranuar në vend të punës. Në këtë rast ne si PDK e kemi shqetësimin tonë se anëtari i cili është votuar në KK, ka tri raste për keqpërdorime në gjykatë. Për një rast ne kemi edhe dokumentin dhe me këtë rast ky person nuk ka të drejtë ta ushtrojë dhe përfaqësojë KK në një kompani publike ku është aksionare edhe Komuna e Gjilanit. Pyetje për Zyrën Ligjore është se aduhet ky person i cili është akuzuar të vazhdojë të ushtrojë këtë detyrë, apo duhet ne si KK ta suspendojmë deri në përfundimin e procedurave gjyqësore?

Isa Agushi – KK i ka zgjedhur aksionarët, prandaj ata duhet të vijnë të japin llogari në KK dhe jo drejtori ? E dyta mua më intereson që ta dijë se çka është duke ndodhur në Kompaninë “Eco – Higjiena”? Ku është Komisioni i aksionarëve të cilët ne i kemi emëruar, por të cilët asnjëherë nuk kanë ardhur për të raportuar në Kuvend? Unë kam kërkuar nga Kuvendi për të vërtetuar se a janë përmbushur obligimet e investimeve prej 51%? A i ka bërë ato investime ai zotëria apo jo? Të formohet një komision i veçantë për këtë rast?

Zijadin Maliqi- këtë që po e thotë z. Agushi nuk është debat për nën të ndryshme, por kjo duhet të debatohet në mbledhjen e ardhshme përmes mbledhjeve përkatëse, pasta edhe përmes Kuvendit ku mund të bisedohet për PPP-në.

Ismail Jonuzi- sa i përket bordeve dhe aksionarëve, këta zgjidhen me konkurs dhe KK i zgjedh këta trupa. Sa i përket rastit që e përmendi z. Riadi, drejtorja nuk merret me hetime, as me individ të caktuar dhe përderisa nuk ka vendime gjyqësore, ne nuk mund të prejudikojmë asgjë. Raport të komisionit të aksionarëve nuk kemi pasur, por ne e kemi angazhuar një auditim të jashtëm për t' i audituar pasqyrat financiare, sepse aty ka mospajtime të mëdha. Ky auditimi është bërë për vitin

2012/13 dhe tash për vitin 2014. Në mbledhjen e para disa ditëve është raportuar për vitin 2014 dhe është raportuar aprovimi i një auditori të jashtëm për pasqyrat financiare. Bordi e ka për obligim që nga muaji mars për ta aprovuar raportin, kurse komisioni i aksionarëve deri në fund të muajit qershor e ka për obligim për të raportuar. Ne në seancën e radhës do të raportojmë për të dy kompanitë me raporte të audituara.

Isa Agushi- z. Riadi e ka një aktakuzë të vitit 2013, por zotëria në fjalë e ka fituar gjyqin për t' u kthyer në vend të punës, prandaj pyes pse e pengon "Eco Higjiena" atë person që e ka fituar kontestin gjyqësor të kthehet në punë?

Me këto debate dhe vendime, seanca i përfundoi punimet në ora 15.45

Procesmbajtësi

Sali Hasani

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjkau- Rexhepi